

MENELLA TOTONI

E FOLMJA E BREGDETIT TË POSHTËM

(Skicë)

Në këtë punim po japim përshkrimin e të folmeve të fshatrave Piqeras (P.), Borsh (B.) dhe Nivicë-Bubar (N.). Këto fshatra bëjnë pjesë në krahinë e Bregut të Detit (ose siç e quan shkurt populli «Bregu»), që fillon prej Palasës deri në Sarandë. Kjo krahinë e njohur për kryengritjet e vazhdueshme për pavarësi kundër pushtonjësve otomanë, është quajtur Himarë¹⁾. Po

aty nga shekulli i XIX (në kohën e Ali Pashë Tepelenës, kur ky i nënshtroi këto fshatra dhe ua hoqi privilegjet që gëzonin, ose pas tij) fshatrat prej Borshit e poshtë u lidhën administrativisht me Delvinën. Me sa duket, që prej asaj kohe emri Himarë filloi të kufizohet si krahinë në fshatrat rreth fshatit Himarë (Qeparo — Palasë).

Himarën e sotme fshatarët e këtyre anëve e quajnë edhe «Bregu i Sipërm», ndërsa prej Borshit e poshtë «Bregu i Poshtëm.»

Fshatrat Piqeras, Borsh e Nivicë bëjnë pjesë në Bregun e Poshtëm.²⁾ Kjo krahinë shtrihet buzë detit Jon në këmbët e malit Lavan dhe kufizohet nga veriu me krahinat e Himarës e të Kurveleshit, nga lindja me Kurveleshin e Rrëzomën dhe nga jugu me fshatrat e Vurgut të banuara prej minoritetit grek.



1) «Krahina e Himarës përfshinte në shek. e XV viset jugperëndimore të Shqipërisë — krahinat e sotme të Himarës, Kurveleshit dhe Tepelenës — një zonë prej afërsisht 50 fshatrash, në pjesën më të madhe fshatra malorë.» (Historia e Shqipërisë. Vëll. I, fq. 318).

2) Veç këtyre në Bregun e poshtëm hyjnë dhe fshatrat: Sasaj, Lukovë, Hundedovë dhe Shënvasi. Më përpara kjo krahinë duhet të ketë përfshirë dhe Lëkurësin, po tani ky fshat i djegur nga grekët më 1878 nuk egziston më.

Qendra administrative dhe ekonomike e kësaj krahine (njëkohësisht dhe qendra e rrethit të Sarandës, që përfshin edhe Delvinën e Konispolin) sot është qyteti i Sarandës, i cili nga një skelë e vogël me ndonjë magazinë e dyqan ka marrë këto 30-40 vjetët e fundit pamjen e një qyteti ³⁾. Më përpara Bregdeti i Poshtëm varej administrativisht dhe e bënte pazarin në Delvinë, nga e cila është larg 6-9 orë më këmbë, po duhet të theksojmë se, derisa shteti shqiptar nuk ishte konsoliduar mirë, kjo krahinë ka patur marrëdhënie ekonomike sidomos me Korfuzin.

Me ndarjen administrative të fundit Bregu i Poshtëm është një lokalitet më vete me qendër në Piqeras. Vitet e fundit janë bashkuar me këtë lokalitet dhe fshatrat Çorraj e Ftterrë të Kurveleshit.

Degët kryesore të ekonomisë së kësaj krahine janë olivikultura, agrikultura dhe frutikultura. Një vend të rëndësishëm zë blegtoaria, ndërka bujqësia për shkak të mungesës së tokës vetëm në Nivicë-Bubar e Shënvasi është dega kryesore e ekonomisë. Banorët e Piqerasit dhe të Lukovës janë marrë edhe me lundrim. Me barkat e tyre bënin tregti me Italinë e Austrinë (shpinin atje grurë, bagëti etj. dhe merrnin andej mallra të ndryshme).

Martesat bëheshin kryesisht brenda fshatit, po edhe me fshatra të tjera të Bregdetit. Borshi dhe Sasaj, të vetmit fshatra me popullsi muslimane në të gjithë Bregdetin, jepnin e merrnin edhe me Rrëzomën (Tatzat) dhe Kurveleshin (Ftterrë, Çorraj).

Ndryshimi i fesë, që i ka ndërprerë marrëdhëniet faqefisnore midis fshatrave ortodokse të Bregdetit dhe fshatrave muslimane të Rrëzomës dhe Kurveleshit, nuk ka mundur të zhdukë marrëdhëniet e tjera. Në luftër kundër pushtonjësve turq këto kanë qenë gjithëni të bashkuara.

Borshi, më shumë se çdo fshat tjetër i Bregdetit, ka patur marrëdhënie me Kurveleshin, me të cilin e lidhte afërsia teritoriale e sidomos feja.

Në fshatrat e krishtere ka patur shkolla greke, në Borsh mejtep. Në kohën e luftës së I-rë botnore në Piqeras u hap një shkollë ku mësohej në gjuhën italiane. Shkolla shqipe është hapur në Piqeras aty nga viti 1920. Sot fshatrat Borsh, Piqeras, Nivicë kanë shkolla shtatvjeçare.

o
o o

Për shkak të luftimeve dhe kryengritjeve të vazhdueshme në këtë krahinë ka patur lëvizje dhe shpërngulje të shpeshta të popullsisë. Këtu kanë ardhur vazhdimisht banorë nga krahinat e brendëshme të vendit.

Nga shpërnguljet më të mëdha, për të cilat flasin pleqtë është ajo e banorëve të Piqerasit në vitet 40 të shek XVIII. Legjenda thotë që kjo ndodhi për shkak të grindjes me borshjotët. Borshi, qendër e një garnizoni turk (këtu ndodhet një kala mjaft e vjetër që në histori njihet me emrin kalaja e Sopotit), në këtë kohë pjesërisht ose tërësisht ishte muslimanizuar dhe, megjithëse lidhjet e giakut ishin ende të afërta, midis tij dhe fshatrave të krishtere përreth duhet të ketë patur mosmarrëveshje e grindje të nxitura nga turqit.

3) Saranda është populluar me banorë të ardhur kryesisht nga krahinat lahe e çame, po nuk mungojnë dhe të ardhur nga krahina të tjera të Shqipërisë

Një herë (1744)⁴) burrat e Borshit të përkrahur nga disa fterrtotë e çorraj vendosën të sulmonin Piqerasin (ndofta për punë të kufive). Banorët e Piqerasit, të lajmëruar për këtë sulm, u bënë pritë dhe u ranë në befasi e vranë prej tyre 25 veta. Për këtë ngjarje këndohet edhe një këngë në Piqeras: Rij Hadua në Sopot /Rij e shkruan në shklop /Sa vigje do shkojn sot /Njëzet borsh e tre fterjt / E di çaraj goricjot, \.

Pas kësaj ndodhie, për t'i shpëtuar ndëshkimit, piqerasjtët u detyruan të lënë fshatin e të shkojnë në Nivicë-Bubar e shumica në Korfuz. Këta të Korfuzit më vonë hidhen në Itali, ku themelojnë më 1746 Vila Badheshën, siç i thonë në Piqeras. Në atdhe mbetën 7 familje: i vovlataj, i xhanaj, i spiraj, i zahaj, i ndreraj, i kondaj dhe i çunaj (?), të cilat, pasi u falën nga autoritetet turke, u kthyen në fshatin e tyre të shkatërruar. Më vonë këtu erdhën edhe familje nga Kallarati e Çorraj të Kurveleshit.

Vitet i zhdukën lidhjet midis Piqerasit dhe Vila Badessës, po pleqtë thonë se në kohën e turqisë paska ardhur andej një Dhimitër Lleshi për të vizituar vendin e të parëve. Më 1936 vajti në Vila Badessa një prej Piqerasi. Sipas tij atje ende flitej mirë shqipja, bile gratë dinin vetëm shqip.

Në Labëri ka dy Nivica. Tjetra ndodhet në Kurvelesh. Pleqtë nuk flasin për ndonjë lidhje midis këtyre fshatrave. Shtesa Bubar për Nivicën e Bregdetit ndofta është bërë për ta dalluar nga Nivica e Kurveleshit. Gojdhëna thotë që emri Nivicë-Bubari ka mbetur pas një lufte pa sukses të Ali Pashë Tepelenës kundër Nivicës për ta nënshtuar. Pozita natyrale e fshatit, mjaft e përshtatëshme për t'u mbrojtur, i ndihmoi nivicjtët, të cilët u futën tmerin ushtarëve të Ali Pashës. Fjala Bubari vjen — sipas legjendës — nga pashirma bu-bu! që e përsërisnin shpesh ushtarët e tmerruar të Aliut. Më vonë Aliu me dredhiti e tij mundi t'i thyejë dhe ta pushtojë Nivicën. Pas kësaj ai e shpërnguli tërë fshatin në Rrëzomë, ku ndenjën deri sa vdiq Aliu. Pas vdekjes së Aliut Nivicjtët u kthyen përsëri në fshatin e tyre dhe me shumë përpjekje mundën të fitojnë atë farë autonomie që gëzonin më përpara.

Për herë të dytë banorët e Nivicë-Bubarit janë shpërngulur më 1912 për shkak të grindjes me bejlerët e Delvinës, që sundonin në ato anë. Kësaj here ata u vendosën në Korfuz, ku qëndruan 6 muaj. Prej andej sollën plot greqizma sidomos të sferës familjare e shtëpijake.

o O o

Kjo e folme nuk është bërë ndonjëherë objekt studimi. M. Lambertz në «Albanische Mundarten in Italien», duke folur për Vila Badessën, thotë: «Gjuha e kësaj kolonie, të cilën e kam studjuar gjatë dy udhëtimeve që bëra në Badessë në vitin 1913 dhe 1914, zë një vend të veçantë midis të gjitha dialekteve lokale italo-shqiptare. Një studim për këtë gjuhë do ta botoj për së shpejti». Për fat të keq ne nuk dimë ta ketë bo-

4) M. Lambertzi në studimin «Albanische Mundarten in Italien» botuar në «Indogermanisches Jahrbuch» vëll. II (fq. 4) jep si datë të themelimit të Vila Badessës vitin 1746. Duke u nisur dhe nga të thënat e pleqve se refugjatët piqerasjtë ndenjën nja dy vjet në Korfuz e pastaj u hodhën në Itali, kjo ngjarje duhet të ketë ndodhur në 1744.

tuar gjëkundë këtë studim, i cili do të na ndihmonte për të parë sa më gjërë zhvillimin e së folmes së Piqerasit gjatë dy shekujve. Në punimin «Italo-albanische Dialektstudien» botuar në «Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung» Nr. 53 (1925) M. Lambertzi boton disa këngë popullore dhe një fjalor të vogël nga Vila Badessa. Në bazë të këtij materiali të pakë do të përpiqem të bëj ndonjë krahasim midis së folmes së Piqerasit dhe asaj të Vila Badessës.

Do të përdoren për ndonjë krahasim edhe ato tekste (besime) që ka mbledhur H. Pedersen në Lëkurës dhe që i ka botuar në «Albanische Texte».

Studimi që po paraqes, është mbështetur në materialet e mbledhura në Piqeras, Nivicë-Bubar, Borsh gjatë një ekspedite të bërë më 1960. Materiali është mbledhur nëpërmjet bisedës së lirë me pleq e plaka dhe me persona të moshës së mesme⁵⁾, nëpërmjet përrallave dhe me anë pyetjesh të tërthorta.

Punimi ka karakter përshkrues. Krahasimet me të folme të tjera janë të rralla. Në përshkrimin e fenomeneve jam nisur nga toskërishtja e përbashkët letrare.

(5) Piqeras:

- 1) Gita Xhani: vjeç 90, bijë dhe martuar në Piqeras, analfabete.
- 2) Ollga Llaçi: vjeç 55, bijë dhe martuar në Piqeras, analfabete, gjuhë të huaj s'di.
- 3) Ndreko Çuni: vjeç 54, bari, ka kryer 3 kl. fillore, ka qenë 3 vjet në Korçë e 2 në Tiranë.
- 4) Kaloqe Gjini: vjeç 72, bijë dhe martuar në Piqeras, analfabete, gjuhë të huaj s'di.

Borsh:

- 5) Alem Hajdini: vjeç 55, ka kryer 1 kl. fillore, i padalë.
- 6) Tefo Hajdini: vjeç 56, analfabete, ka qenë 7 vjet në Turqi.
- 7) Hane Gjika: rreth 60 vjeç, analfabete.

Nivicë-Bubar

- 8) Kalinë Baxheri: vjeç 88, e padalë, gjuhë të huaj s'di.
- 9) Andrea Dhëmërtika: vjeç 85, bari, i padalë, analfabet.
- 10) Miho Gjini: vjeç 64, bari, i padalë, analfabet, gjuhë të huaj s'di.
- 11) Athina Baxheri: vjeç 55, bijë dhe martuar në Nivicë-Bubar, e padalë.

Veç këtyre për plotësimin e saktësimin e materialit kam punuar edhe me pleq e persona të tjerë të moshave të ndryshme, midis të cilëve një ndihmë të konsiderueshme më ka dhënë studenti I. Kabo nga Borshi.

FONETIKA

Zanoret

§ 1. **Theksi.** Theksi në këtë të folme, me ndonjë përjashtim, paraqitet si edhe në toskërishten e përbashkët. a) Në fjalët turke, ose të marra nëpërmjet saj, theksi, si edhe në origjinal, bie në rrokjen e fundit: **babá, bakër, dushemé, çifté, kafé, (kahvé- B), palçá (B), qoshé, siçadé, sufrán,** etj. Fjalët **penxhére** dhe **tenxhére** janë paroksitone, ndërsa **sefté** dhe **séfte** (N.). Nga një plakë në Piqeras dëgjova të theksuara në rrokjen e fundit edhe këto fjalë me origjinë turke: **afié, zaptié,** të cilat jo vetëm në gegërishte, po edhe në toskërishte përgjithësisht theksohen në rrokjen e parafundit. b) Në këtë të folme janë oksitone edhe fjalët: **gjël-priér (N.), h'é (hie — B.), lloít** e fiqe (llójet), **kondô (kóndo — Përmet), perdhé (pérde), piperjé (pipére), piés (pýes).** Këto fjalë, nga të cilat një pjesë janë të huajtura, në toskërishten e përbashkët janë paroksitone. Fjala **mandál (P.)** në Borsh është paroksitone: **mát al,** c) Si në mbarë shqipen theksi çvendoset nga rrënja në prapashtesë në fjalët e formuara me anë të prapashtesave: — ar, — isht, — ak, — ash etj. si: **mëllênj — mëllênjash.** Po në pak fjalë të tilla theksi nuk çvendoset: **zëmërvérdhash, zëmërkúqash (P.)** si edhe tek emrat topikë **Pjëtrash (N.) Alimanjash (N.).** ç) Për t'u vënë në dukje është fakti që në mënyrën habitore folja ka dy theksa: një që bie mbi trajtat e foljes bazë dhe një tjetër që bie mbi trajtat e foljes ndihmëse «kam». Raporti i intensitetit të theksave nuk është gjithnjë i njëjtë. Kur zanorja e trajtave të foljes «kam» është e gjatë, forca e zërit përqëndrohet më shumë mbi atë: **burúaká, punúaká, qenké,**

qenkéj, thenká etj. Kur zanorja e trajtave të foljes «kam» nuk është e gjatë, forca e zërit përqëndrohet pothuajse njësoj si mbi zanoren e trajtave të foljes ndihmëse «kam» dhe mbi atë të foljes bazë **dhënkíni, páskám, qénkám** etj. Në trajtat e habitores të foljeve më -oj, në rastet kur zanorja e trajtave të foljes ndihmëse «kam» nuk është e gjatë, më është dukur që forca e zërit përqëndrohet më shumë mbi zanoren e foljes bazë: **burúakán, punúakíni** etj.

Të qenët e dy theksave në trajtat e habitores, me sa duket, është rezultat i mosaglutinimit plotësisht të trajtave të foljes ndihmëtare «kam» me trajtat e foljes bazë⁶⁾; nga ana tjetër zanoret e gjata të trajtave të foljes «kam» kanë ndikuar shumë në intensitetin e theksit që bie mbi ato trajta.

Këtë fenomen e kam dëgjuar në Borsh, më rrallë në Nivicë, ndërsa në Piqeras nuk kam mundur të regjistroj trajta të habitores.

§ 2. **Kuantiteti i zanoreve.** — Është vështirë të përcaktohen saktësisht shkallët e gjatësisë së zanoreve në një të folme pa ndihmën e aparateve, sepse ndryshimi i tempos së të folurit sjell ndryshimin e zgjatjeve të zanoreve; kështu zanorja e shkurtër në një ligjërim të ngadaltë mund të jetë baras e zgjatur me një zanore të mesme në një ligjërim të shpejtë. Po ngadalësia dhe shpejtësia e ligjërimit janë diçka relative. Prej këtej lind vështirësia e krahasimit aty për aty të kuantitetit të za-

6) Në Kuç ndonjë herë midis trajtave të foljes bazë dhe atyre të ndihmësës «kam» që formojnë mënyrën habitore ndihet një pauzë që krijon përshtypjen se kemi të bëjmë jo me një, po dy fjalë.

noreve. Regjistrimi i ligjërit të subjekteve dhe studimi i kuantitetit të zanoreve, duke patur parasysh tempon e të folurit, është i domosdoshëm për të arritur rezultate të sakta. Vështirësia bëhet edhe më e ndijshme kur, me gjithë këto mungesa, koha e mbledhjes së materialeve është e shkurtër.

[Sido qoftë, në të folmen e Bregdetit të Poshtëm dallohen tri kuantitete zanore të theksuara: zanore të gjata, të mesme dhe të shkurtëra. Zanoret e gjata, që ndihen në shumicën e të folmeve labe, janë nga tiparet kryesore, që dallojnë këtë të folme nga të folmet e toskërishtes veriore.]

Këtu më poshtë do të përpiqem të jap disa rregulla të përgjithshme të kuantitetit të zanoreve në këtë të folme, po në gjendjen e sotme si rezultat i zhvillimeve fonetike ka shumë raste që dalin jashtë këtyre rregullave.

[Ndihen në përgjithësi të gjata zanoret e theksuara në rrokje fundore të hapur: **gja**, **kala**, **vëlla**, **nomë**, **vë**, **kercj**, **kusj**, **mj**, **mullj**, **kam u**, (=uri), **drū**, **gū**, **u ça**, **ka**, («kam» V. III e tashme dëftore), **e pā**, **ke**, **sā**, vëllezër ini? **pā** buk etj.

Ndihen në përgjithësi të mesme zanoret e theksuara në rrokje të hapur në mes të fjalës: **lāni**, **rrāhës**, **goxhivere**, **bodile**, **pōde**, **lūgës**, **qūlle** etj.

Ndihen në përgjithësi të shkurtëra zanoret e theksuara në rrokje të mbyllur: **çaj**, **laj**, **kabash**, **kërmij** (shumësi i «kërmill»), **kongij** (shumësi i «konjill»), **pullak**, **helmeza**, **ibrig**, **korrik**, **potis**, **pos**, etj.

Gjithashtu ndihen të shkurtëra zanoret e theksuara që pas rënies së ë fundore janë gjendur në rrokje të mbyllur: **lopat**, **ken**, **mjet**, **lidh**, **krip**, **hod**, **kok**, **buc**, **xhuf** etj.]

[Po zanoret e theksuara në rrokje të mbyllur para tingujve likuidë, sidomos para r e në disa raste para ll e l, ndihen të gjata: **bar**, **bullar**, **lopār**, **ushfar**, **habēr**, **driktōr**, **gūr**, **haūr**, **shūr**, **kërmjll**, **konjill**, **prjll**, **qull**, **perdhikūl** etj. Në disa raste në Borsh më janë dukur të gjata zanoret e theksuara para r kur ndodhen në mes të fjalës: i **bārdh** **dārdh**, **shpīrt**.

Megjithëse në rrokje të mbyllur, ndihen të gjata zanoret e theksuara edhe në këto fjalë: **dēt**, **kūt**, **shāt**, **urjth** (B.) si edhe te trajta **qënkej** (B., N.). Zanoret e gjata në këto fjalë ruhen gjatë gjithë fleksionit me gjithë ndryshimin e pozitës së zanores së theksuar në rrokje: **dēti**, **dētit**, **kūti**, **shāti**, **shētre**, **urjthēr**, etj.]

[Zanore të gjatë në rrokje të mbyllur, e cila është bërë e tillë pas rënies së ë fundore, ka edhe në këto raste:

a) Në rasat e zhdrejta të njëjësit dhe në emëroren e shquar shumë të emrave që në emëroren e pashquar njëjës mbarojnë me zanore të gjatë: **kusjç**, **shtëpjs**, **xhadës**, **dūn**, **gūn**, **gjan**, **kusjn**, **mjn**, **malljn**, **tūt**, **kusjt** etj. Në Piqerës dhe Nivicë Bubar zanoret e gjata në këtë pozicion, dallohen më mirë se në emëroren e pashquar njëjës të këtyre fjalëve.

b) Në trajtat e së kryerës së thjeshtë shumë dhe në pjesoren e disa foljeve të zgjedhimit të II, të III e të IV: **fūm**, **fūt**, **fūn**, **shkām**, **vram**, **çan**, **grīm**, **vum**, **zūm**, **kam pār**, për të **vrar** etj.

c) Në disa fjalë të tjera: **bāl**, **djāl**, **kāl**, **kilikāz**, **merimān**, **mēlqīnj**, **nūshk**, **vēs** (vetëm në Borsh).

Si përfundim mund të themi:

a) Rënia e zanores fundore ë ka sjellë barazinë tingullore të disa trajtave, të cilat sot dallohen vetëm nga kuantiteti i zanores së theksuar. Kështu: **çān**, **çān**, **grīn**, **grīu** (veta e II dhe e III njëjës e së tashmes) dhe **çān**, **grīu** (veta e III shumës e së kryerës së thjeshtë), **poçār** (njëjës) dhe **poçār** (shumës; zanorja e theksuar e mesme), **pllocār** (njëjës) dhe **plloc-kār** (shumës; zanorja e theksuar e mesme), **çarçāf** (nj.) dhe **çarçaf** (sh.; zanorja e theksuar e mesme), **shelē**; (nji) dhe **shelég** (sh.; zanorja e theksuar e mesme).

b) Rastet e tilla, ku kuantiteti është i vetmi dallues i trajtave të fjalëve janë të paka në krahasim me rastet e tjera, ku kuantiteti nuk lot një rol të tillë diferencues morfologjik e semantik, prandaj nuk mund të bëhet pohimi kategorik se kuantiteti i zanoreve të së folmes së Bregdetit të Poshtëm është i tipit fonologjik; ai kryesisht është i tipit fonetik. Dhe me të vërtetë, faktorët fonetikë lozin rol më të madh në kuantitetin e zanoreve. Kështu zanorja e theksuar para likuides **r** është e gjatë jo vetëm në fjalët e vjetra shqipe, por edhe në fjalët e formuara vonë dhe të marra hua si: **ushtār**, **asqer**, **habēr** etj.; ose ndryshimi i bashkëtingëllores që mbyll rrokjen, sjell ndryshimin e kuantitetit të zanores së theksuar: **konjīll**, po **konjīj** etj. Rënia e zanores ë, e cila në të folmet geqe sjell zgjatjen e zanores së theksuar, këtu sjell shkurtimin e saj: **kōk** etj.

Po në disa raste të tjera, që u përmendën më lart, rezultatet janë të kundërta, zanorja e theksuar del e gjatë. Mos vallë i njëjti fenomen ka dhënë rezultate të ndryshme? Këtu do të lejojmë të përsëris tezën e prof. E. Çabejt, sipas së cilës «... për gjatësinë ose për shkurtësinë e një zanoreje në gjuhën e sotme nuk peshon aqë fort theksimi i saj, as vendi që ka kjo brenda fjalës, sa peshon një kriter historik, puna nëse kjo gjatësi është vazhdimi i një gjatësie origjinale të herëshme apo jo». ⁷⁾ Nuk dua të përsëris këtu shembujt që sjell prof. E. Çabej në studimin e lartpërmendur, por dua të them se edhe rastet e tjera, që duken si përjashtime (këtu mund të shtojmë dhe shembuj të tjerë të tillë si: **pā** buk, **sā** vëllezër ini? dhe thomi **nā**/, **īā** tuk **kī** fiku/ etj., ku, megjithëse pozicioni fonetik është i njëjtë, kuantiteti i zanoreve është i ndryshëm), po të shihen nga pikëpamja historike, mund të gjejnë spjegim. Mua më duket se zanorja e gjatë në rasat e zhdrejta në emrat e tipit **kusi**, në të kryerën e thjeshtë dhe në pjesoren e disa foljeve (si **ūm**, **çān**, kam **fār** etj.) nuk është rezultat i rënies së zanores fundore **ë**, as i pozitës në rrokje, si nuk është rezultat i saj edhe te fjalët **dēt**, **lūt** etj. dhe as rezultat i nevojës për të diferencuar trajtat e njëjta nga përbërja tingullore. Mbështetje për këtë janë auktorët e vjetër, tek të cilët (krahas rasteve të kundërta) në këto raste ka zanore të gjatë: ndë **dhē** ⁸⁾ (24 a 40), **pēmbī mēnīt** të anēmiquet (23 b 38), **sytē** (22 b 38), **hītē** (76 b10), **īyū** (77 b 37-38), **pām** (77 b 38) **pntē** (73 b 16), **pānē** (43 b 7), **rām** (63 a 9), **ānē** (75 a 18), **pērzūm** (51 a 32-33), **shpūne** (72 a 23), me klenë **nāū**

7) E. Çabej: «Kuantiteti i zanoreve të theksuara të shqipes» Bul. i Univ. i Sh. Sh. Nr. 2, 1957 (fq. 207-213).

8) Shembujt nga Buzuku po jepen sipas transkriptimit të E. Çabejt (dorëshkrim)

(178 a 17), me **pinë** (75 b 19) etj. (Buzuku); qiellë e **dhënë** e **detinë** etj. (Budi).

§ 3 — **Nazalizmi**. Zanoret e theksuara para nazaleve përgjithësisht, janë gojore. Po në fjalë të tipit **mullī** të cilat historikisht kanë patur në fund **n**, zanorja e theksuar karakterizohet nga një farë nazaliteti: **mullī**, **gju**, **tu**, etj. Zanore hundore të tilla dëgjohen më shpesh në Borsh, ndër sa në Pigeras i kam vënë re në të folmen e një personi e sidomos në rasën kalizore të këtyre emrave: **kërcin**, **nin**, **sin** **gjun** etj.

Në Borsh pas bashkëtingëllores (\bar{n} (< nd.) η (< ng.) dhe **nj** (< ngj.) zanoret që vinë pas tyre, qofshin këto të theksuara ose të patheksuara, fitojnë ngjyrë nazale: **nuk**, **sënuq**, **nr̄dhi**, **shtr̄noj**, **ñillohet**, **konjill**, **shënjinës** etj.]

§ 4. **Zanorja «e»**. Zanorja e e theksuar e toskërishtes së përbashkët, që ndodhet para tingujve nazalë ose para tingujve që janë rezultat i zhvillimit fonetik të nazales **n** e **nj**, ndihet **ë**, po herë herë pak më e mbrapme se **ë** e theksuar e toskërishtes së përbashkët në fjalët «bëj» «këmba» etj.: **pënd**, **qën**, **vë-vën**, **pë-përi**, **flë**, **plët**, **që-qëri**, **rë-ja** (B. = reja), **ëmër**, **fëmër**, **Golëm**, **kalëmat**, i **kështër** (< i krishter), **thëmbër**, **frënjëz**, **lumënj**, **qënjgj** etj.

Dëgjohen me një **ë** të tillë edhe disa fjalë që përgjithësisht në shqipë kanë e gojore: **ngrë**, **prëhëm**, **shërp** (B. = sherp).

Nuk është kthyer në **ë** zanorja e e theksuar para nazales **nj** në shumësin e disa emrave, që vjen nga metafonizimi i zanores **a**: **çakenj** (çakall), **lostenj** (lostar), **pshenj** (pshal), **strenj** (strall).]

§ 5.- **Zanorja «ë»**. a) Zanorja **ë** e theksuar e toskërishtes së përbashkët, që ndodhet para nazaleve ose para tingujve që janë rezultat i zhvillimit fonetik të tyre, është gjithashtu një **ë** herë herë pak më e mbrapme se ajo e toskërishtes së përbashkët: **ergjënd**, **lë-lën**, **njëri**, **thëllëz**, **zë-zëri**, i **ëmbël**, **lëmi**, **këmb**, **bëj**, **rrënj** etj.

Është kthyer në **ë** dhe **a-ja** e theksuar para nazaleve në disa fjalë, shumica të huajtura nga turqishtja, të cilat në toskërishten e përbashkët shqiptohen me **a**: **dumën**, **hamëm**, **harëm**, **marhamën**, **mën**, **Osmën**, **pishmën**, **Sarënda**, **Sulejmën**, **tamëm**, **tumën**. Në disa fjalë ndihet **a** në vend të **ë**: **vath** (P = vëthi), **gjakund**, **mastrapan**, **mashan** etj.

Në shqiptimin e ndonjë personi, sporadikisht, **ë** e theksuar ndihet pak labiale: **kam bër**, **tanëm**, **mën** (P.)]

b) I — Zanorja **ë** e patheksuar ruhet mirë në rrënjë të fjalëve dhe përgjithësisht në pozicion para zanores së theksuar: **dëgjoj**, **dënim**, **fëlli**, **këpuca**, **këput**, **këtu**, **ndërroj**, **përallëz**, **vëlla**; **bagëti**, **çkatërroj**, **përçelloj** etj., po edhe **krrej**, **prroi**, **prallëz**.

Në pozicion semiprotonik **ë** është ruajtur më mirë kur nuk ndodhet para bashkëtingëlloreve likuide ose para **s**: **astëkëve**, **helmëza**, **këmbëza**, **shokëve** etj., ndërsa kur ndodhet para tyre herë herë ruhet, po në shumicën e rasteve bie: **lëkundja** është e papërcaktuar ndodh në të njëjtën fjalë e në të njëjtin person:

a) **brëshëri**, **emëri**, **cingëra**, **lëkostëra**, **prindërit**, **talëri**, **vëllezërit**;
b) **and(ë)re**, **ëm(ë)rin**, **gjisht(ë)rit**, **gjuhist(ë)ra**, **kec(ë)rit**, **shtrap(ë)ra**, **ball(ë)si**, **djep(ë)si**, **qep(ë)sit**, **tim(ë)si**, **boçk(ë)la**, **të vog(ë)la** etj.

Ka rënë gjithkund ë, fundore e patheksuar: **brumët, gllënjëz, muarm, plasij; buk, hall (<hallë), kam (<kamë), lug, krip, kunj, ku- rjë),** take qar, të tër qem etj.

Ka rënë gjithashtu edhe ë në fund të komponentit të parë në fjalët kompozita: **cullbejk, gushkuq, kokkafet, llapmëllënj, mirkëshillazi** etj.

Nuk bie ë fundore në disa fjalë njërrokëse si parafjalë, lidhëza, n- ja, trajta/ përemrore të shkurtëra etj.: këcen **më të** posht/, e la **më** shtë- pi/, ajo rij **në** penxhere/ (P.), të nesmen, të vogla, nuk **më** duket/, t'i jap, sh **të** të ndodhet/ etj.

Në fjalët e fundit të fjalive pyetëse, e shoqëruar nga një zgjatje karakteristike e zërit, dëgjohej një ë fundore, shpesh edhe atje ku s'ka qenë: e ç'do të bëj a i **v**rarë? do **v**ras vetenë? po vëllau ka **v**aturë?, so- të?, këtu **përposhë?** etj.⁹⁾

II — Në disa fjalë të dëgjuara në Piqeras një ë e patheksuar ka dhënë u si rezultat i asimilimit ose për shkaqe të padiktueshme fonetike: **burruc (< bërruc), cinxur (< cinxër), kushuri (< kushëri), umur (< ymër), kulish (< këlish), munoj (< mënoj), xxxx u murzita (< u mër- zita), mushtjer (< mëshjtjer).**

III.- Gjithashtu në pak raste një ë e patheksuar ka dhënë i: **gjilmi- tër, (B.< gjëlmitër), kilikaz (B.< kilkaz < këlkazë), Shimitër (P.< Shën Mitër).**

§ 6.- Zanorja i prapa një zanoreje të theksuar nuk jotizohet. **argloi, babai, ftoi, thoi, maroi, qëndroi** etj.

Para një zanoreje të theksuar zanorja i në disa fjalë ndihet i e në disa të tjera **j:ti** erij, shpierij, lieva, thieva; **mjell, pjell, vjell, ja nga- iova, ju bë elb, komishjon, radjo** etj.

§ 7.- Në sistemin e fonemave të kësaj së folme nuk bën pjesë fonema y. Zanores y në fjalët me origjinë jo turke të toskërishtes së përbashkët i përgjigjet në këtë të folme zanorja i: **grik, pasqira, pill, qiqe, si, ki, për tia, dizet, frij, ndrishoj, ngriset** etj.

9) Në të folmen e Vila Badesës zanorja ë e patheksuar fundore paraqitet e lëkundëshme. Megjithëse materiali që sjell M. Lambertz, janë poezi popullore dhe sidomos për këtë çështje, ato s'mund të kenë vlerë absolute, sepse në ruaj- tjen dhe rënjen e ë fundore mund të lozë rol ritmi, prapë se prapë mund të thuhet se ë fundore në përgjithësi ruhet: «Ç'jan ata, qi **vijënë-/ Vijënë të marrenë-/**, «**Emmë njerënë ta pi!**», «**Emmë**, dhe mua molle t'ëmbla!», «**Me futë ndolisurë/ Me grikë stolisur**» etj. Po jo rrallë ë fundore (më shumë ë fundore në fjalët proparoksi- tone) bie: «**Krushqit e radhës**», «**gjeti të shoqin të dekur**», «**Një milënjë e zez jesh/ Tre bel' u bë dor i kesh**», «**Se u kam një burr të marr!**» etj. A është ky fenomen i lëkundjes së ë fundore i vjetër, aq i vjetër sa edhe largimi i shqip- tarëve të Vila Badessës nga Piqerasi, kjo gjë s'mund të thuhet në mënyrë ka- tegorike, po sido qoftë ky fakt si edhe lëkundja e ë fundore në të folmen e Lë- kurësht (1893) (edhe atje thuhej: **natësë, nisetë, parmëndënë, udhënë, do bëjë, lubisë** etj., po krahas këtyre rasteve që përbëjnë shumicën, jo vetëm në fjalët proparoksitone, po edhe në fjalët paroksitone hasen raste ku ë fundore ka rënë: **prishen, rrobat, zjarrin, do bëj dimër, pengojn, shtëpis** etj.) tregojnë se fillimi i këtij fenomeni në të folmen e Bregdetit të Poshtëm duhet të jetë i hershëm (pra para 1893).

Në të folmen e Vila Badesës ë e patheksuar në disa raste është regjistruar si e. Një fenomen i tillë nuk vihet re në Piqeras, po është i zakonshëm në disa të folme gege. Në V.B. ë është regjistruar si e në këto raste: në fund të fjalës: **molle t'ëmbla, të marme** Korfuskal/are» (< marmë = marrim); në pozicionin jofundor në rrokjen pas rrokjes së theksuar: **mollet (< mollët), cohënë (< co- hënë) marrenë** (marrënë = marrin), **vijenë (< vijënë = vijinë),** po edhe **ditën, vëmënë** etj.; në rrokjen para rrokjes së theksuar: **qeron, po këndon** etj.

Zanorja **y** e fjalëve të huajtura nga turqishtja është shndërruar në **u**: **burek, dufek, dusheme, dushek, huqëmet, musafir, urijet** etj. Aty këtu hasen dhe raste ku **y** e këtyre fjalëve ndihet **i**, krahas **u**: **gjim** (N. **gjumb** — P., **gjum** — B), **birazer** dhe **burazer** (N.).

Diftongje dhe togje zanoresh:

§. 8 — Togu zanor i vjetër **uo** është shndërruar në **ua**, i cili, me që theksi bie mbi **u** (úa) dhe zanoret shqiptohen veçmas, paraqitet si tog zanor, si në mes dhe në fund të fjalës: **i hûaj, gatûaj, kalûar, kundrûall, mûar; ftûa, grûa, mûa, u punûa, sorûa, sûa** etj.]

§. 9 — Togu zanor i vjetër **ie** ndihet si tog zanor, si diftong dhe si **je**. Ndihet tog zanor në fjalët: **e diei, diell, fier, kshiell, miell, qiell, rrieth-i, i kthiellt**, si edhe në të tashmen e foljeve **bie, shpie, ziej; biem, shpien, zien, ziejm** etj.; theksi bie mbi **i** (**ie**) dhe zanoret shqiptohen si dy rrokje.

Në të pakryerën, në urdhënoren dhe në të tashmen e lidhores (V. III, njëjës) të foljeve **bie, shpie**, si edhe në të kryerën e thjeshtë (njëjës) të foljes **ziej, ie** ndihet si ditong; theksi bie mbi **e** (**ie**), ndërsa zanorja **i** shqiptohet si gjysmë vokale: **bi̇erij, shpi̇erij, bi̇ena, shpi̇ere, të bi̇er, të shpi̇er, ziėva, ziėu**.

Në trup të foljeve të zgjedhimit të I klasa e II **ie** herë ndihet si tog zanor e herë (në shumicën e rasteve) si **je**, në rastin e dytë theksi është çvendosur, mbi **e**, ndërsa zanorja **i** është konsonantizuar: **miell, miell, të piell, tierrëm; mjël, mbjëll, ndjëll, pjël, tjërr, vjëll** etj.

Togu **ie** ndihet **je** edhe në ndajfoljen **dje**.]

§. 10 — Togut zanor **ye** të toskërishtes së përbashkët i korespondon në këtë të folme **ie**. Kjo **ie** ndihet kryesisht si tog zanor: **liej, në krie**, kish **krier, njëej** (= ngjyiej), **thiej**.]

Tek folja **pies, ie** ndihet si tog zanor (N.), si diftong, si **je** e ndonjëherë edhe i (P.) **piesëm, pieti, pien, piesëm** (P.), **piem** (N.) **pies, piem, ieta** (B); **pëjësëm** (N.), **pëjëtimi, pëjëti** (B.); pa më **pit** mua./

Ky tog zanor është shndërruar në diftong edhe në dy vetat e njëjësit të së kryerës së thjeshtë të foljeve që mbarojnë në të tashmen me **-iej** (=yej) si: **thiej, liej; lieva, lieve, thieva, thieve** etj. Në vetën e tretë mbaresa **u** shqiptohet bashkë me **ie** si një rrokje e vetme, pra kemi një triftong: **liëu, thiëu** etj. Ky fenomen haset në Piqeras dhe në Nivicë, kurse në Borsh si në toskërishten e përbashkët **ie** (= ye) mblihet në këto raste në **e**: **leva, theva** etj.]

Bashkëtingëlloret

§ 11 — Bashkëtingëllorja **h** ruhet mirë në fillim të fjalës: **haliq, huf, helmez, hurdhe, ha, harroj, heq, hedh** etj. Në Nivicë në nja dy raste kam dëgjuar një **h** të shtuar në fjalë që fillojnë me zanore: **hoborr, hunaz**.

Në mes të fjalës **h** ruhet mirë atje ku është element primar i fjalës. **buhari, duhan, muhabet, rehat, brihal, gjuhistër, i përhapur** etj. Para-

qet lëkundje **h** antihiatizuese që shtohet midis temës dhe mbaresës në trajtën pësore të foljeve: **dëgjo**het, **di**het, **la**hej, **mundo**hej, **vi**hej, po edhe **zi**em etj.

Në fund të fjalës **h** dëgjo

het mirë në Borsh, po paraqitet mjaft e dobësuar dhe shpesh nuk ndihet në Piqeras dhe Nivicë: **leh**, **nih**, **njoh**, **pa**ñeh, **plëh**, **silah**, **stomah**, **shoh** etj. (B.) **kra**^b, **ngro**^b, **njo**^b, **shc**^b, **gju**^b, (< gjuhë) (P., N.). Lidhur me këtë **h** ndihet e dobët dhe shpesh nuk ndihet fare gjatë fleksionit të këtyre fjalëve ose në fjalët e formuara prej tyre me anë prapashtesash: **ndim** (< ndihmë), **do raç** (< rrahç), **i ftot** (< i ftohtë), **i ngrot** (< i ngrohtë) etj.

§ 12. Në Piqeras dhe Nivicë-Bubar në disa fjalë të huajtura nga greqishtja dhe në nja dy fjalë të brumit shqiptar ndihet një tingull frikativ i shurdhët mesgjuhor. Gjatë shqiptimit të tij pjesa e mesme e gjuhës ngrihet drejt qiellzës së fortë, ku formohet shtegu. Ky tingull, që ndoshta është ndikim i greqishtes, nuk më duket të jetë i njëjtë me tingullin **χ** të saj: **ah**erë, **he**, **h**ers, **hi**roladh (shih fj. «pamënda»), **Hi**mar, **Ma**he (= onom. Maçe) **ma**liher, **ra**he, **stomah** etj.¹⁰

Në Borsh këtij tingulli i përgjigjet tingulli **h**: **ah**ere, **hie**, **Hi**mar, **ma**liher. Po tingullit **h** në **H**ers në Borsh dhe Piqeras i përgjigjet tingulli **q**: **q**ers.

§ 13. Në Piqeras dhe Nivicë, në disa fjalë bashkëtingëllorja **k** para zanoreve palatale ka dhënë **q**: **Leskovi**qi (< Leskovik), **q**illo (< kile), **q**iqirike (< kikirike), **ra**qi (< raki).

§ 14 — Bashkëtingëllorja **q** (edhe kur vjen nga shurdhimi i një **gj**) (para tingujve **t**, **m**, **n**, **ç** shndërrohet në **j**: **arm**ijt, **të li**jt, **m**ijt, **ple**jt, **u** **po**jt, **zo**jt, (< zoqt < zogjtë) **u** **po**jm, **u** **tër**hojm, **d**ijn (= vdiqnë), **u** **ndre**jn, **ho**jn dor, **hi**jniç, **u** **do**ç (< u doçç < u dogçç) **u** **po**ç etj.

Bashkëtingëllorja **ç** > **j** edhe pas tingullit **ç**. Para zanores **i** kjo **j** humbet fare: **ç**jep (çqep). **ç**it (< çjit < çqit), **ç**itës **ç**qitës), po edhe **ç**quaj. Ndihen me **j** e **jo** me **q** edhe fjalët: **ç**ap (= çqap) **ç**qufur (= squfur) **ç**jullëhem (< squllëhem), **ç**jetull (= sqetull), **ç**jarim (< sqarim).

Në Piqeras dhe në Nivicë **q** > **ç** në fjalën **ç**ish (= qysh), ndërsa në Borsh në fjalën **lakuriç** (< lakuriq).

§ 15 — Me përjashtim të Nivicës, ku vërehen lëkundje, bashkëtingëllorja **gj** pas tingullit **x** shndërrohet në **j**. Para zanores **i**, **j** (< gj) humbet fare: **x**jebez (= zgjebe), **x**jedh (= zgjedhë), **x**joj (= zgjoj), të **x**juar (në N. edhe **x**gjoj), **x**idh (**x**ith — B. < **x**jidh < **x**gjidh),

§ 16 — Bashkëtingëllorja **nj**, si përgjithësisht në të folmet labe, ka pësuar ndryshime, sidomos kur është mbaresë. Procesi i shndërrimit të **nj** në **j** është në zhvillim e sipër.

I — **Nj** ruhet mirë në rrënjë të fjalës, qoftë sot edhe fundore: **nj**erk, **nj**oh, **ndë**nja, e **shtrë**njt, **drë**nj, **gër**nj, **zonj**, **rrë**nj, etj., po edhe **ndë**jtim, e **shtrë**jt.

II — Bashkëtingëllorja **nj**, jo në rrënjë të fjalëve, paraqet lëkundje. Në sistemin foljor, qoftë dhe jo fundore, **nj** > **j**: **bë**j, **g**jëj, **lie**j, **kër**cej, **puno**j, **dali**j (= dilja), **u** **do**j të **vi**j (= doja të vija), **marri**j, **vras**ij, **dal**je, **puno**je etj.

10) Një tingull ndofta i tillë, po sidoqoftë jo **h**, ndihet edhe në Vila Badessë **χ**ie (=hie).

Përkundrazi, në shumësin e emrave në shumicën e rasteve ruhet: **ftonj, langonj, lëmënj, lumënj, llullenj, mullinj, pënj, qirinj, shapinj, thonj, ullinj** etj., po në të njëjtën fjalë dhe në të njëjtin person **nj** ndihet edhe **j**: **ftoj, gjërpëj, peshllij, sendoj, shkëmbëj, ullij** etj.]

§ 17.- Në Nivicë e Piqeras një **j** e ardhur nga bashkëtingëlloret **I, II, r**, ka dhënë **nj**. Ky fenomen vërehet më shumë në shumësin e emrave e më sakt në shumësin e atyre emrave që krahas kthimit të **I, II, r** në **j** metafonizojnë dhe zanoren e rrënjës: pshenj (< pshej, nj. pshal), **çakenj** (< cakej, nj. çakall), **strenj** (< strej, nj. strall), **lostenj** (< lostej, nj. lostar), **gërthënj** (P. < gërthëj < gërthël). Në kthimin e këtyre tingujve në **nj** ka lojtur rol edhe analogjia me shumësin e emrave me **-nj**.

§ 18.- Bashkëtingëlloret e vjetër **l** e palatalizuar **si** në shqipen e përbashkët, ka dhënë **j**, vetëm në nja dy shembuj të dëgjuar në Borsh ajo ruhet: **gërthël** (= gërthje, në P. **gërthënj**), dardh **kuqla** (= kuqje).

§ 19. — Bashkëtingëlloret dridhëse e gjatë **rr** nuk ndihet njësoj në këtë të folme. Në disa fjalë **rr** karakterizohet nga një intensitet më i madh i rrymës së ajrit në krahasim me shqiptimin e **rr** në të folmet gëge, gjë që **shkakton** një numur më të madh dridhësh të majës së gjuhës: **bërruc, bërrul, kërrej, kurris** etj. Në Piqeras një **rr** të tillë e kam dëgjuar, ndoshta në një masë më të madhe, vetëm nga një bari, i cili kish-te punuar edhe në vende të tjera të Labërisë. Në shumicën e shembujve **rr** më është dukur si tingulli i zakonshëm **rr** i shqipes.

Në Piqeras sidomos në brezin e mesëm dhe të ri bashkëtingëlloret **rr** ndihet **r**. Në brezin e vjetër krahas rasteve me **r**, që përbëjnë shumicën, hasen edhe raste me **rr**, kjo tek i njëjti person dhe bile tek e njëjta fjalë: **fur, haroj, karike, krej, mar** dhe **derr, marr, zjarr** etj. 11)

§ 20.- Në disa fjalë ndihet **dh** në vend të **d**. Në disa prej tyre të huajtura nga greqishtja ruhet tingulli i greqishtes: **dhelfin, dhialekt, gradha, kadhron, modha**. Në disa të tjera **d** > **dh** sidomos në grupin **rd** (**rd** > **rdh**, fenomen i njohur për shqipen dhe që vërehet edhe në fjalët e huajtura nga turqishtja etj.): **gardhel, perdhe, sardhele, Badhesha** etj.

§ 21.- Në pak raste **sh** e **ç**: **çkors** (< shkorsë), **puçk** (< pushkë), **puçkatoj**.

Në ndonjë rast tjetër **ç** > **sh**: **bekshi** (< bekçi), **sulltiash** (< sultiaç).

§ 22. Fishkëllonjësja **s** shpesh zëvendësohet nga afrikatja **c**, sidomos para bashkëtingëlloreve të shurdhëta: **çfunji** (B. < sfungji), **çkllav, çjap, çjufur, çjaroj** (B. < çqaroj < sqaroj), **çjullëhem** (B. < squllëhem), **çklinjem** (B. < skinjem < ksijnjem); **çpurdhjak** (B.) **çfuqar** (B. < çsfungar), **çmir** (< smir); **çimilar** (P. < smilar), **dica** (< disa) **krici** malit (< krisi), **kurcej, terc** (N. < ters).

Në disa fjalë, shumica të huajtura, vërehet, shndërrimi i **s** > **sh**: **Badhesha** (P. < Badesa), **bisakota** (P. < biskota), **bëshardh** (N. < bastardh), **grashi** (B. < igrasi), **kishmet** (P. < kësmet), **komishjon** (B. < komision). Në fjalët ashish (< asish) **kshish** (< kësish) mund të kemi

11) Në Vila Badessë ndihet tingulli **rr**, bile janë regjistruar me **rr** disa fjalë që kanë **r**: «se u kam një **burr** të **marr!**», Vate maçi e **rr**i e haj»; **rraki** (< raki), **kundrr** (< kundër). Po në një rast: **të marme** (= të marrim). Ky rast tregon lëkundje apo është gabim shtypi?

një asimilim konsonantik regresiv, ndërsa në **kshoje** (< ksoje) në trajtë analogjike me të parat.

§ 23 — Në këtë të folme, në pak fjalë, ndodh që të përdoret I në vend të II e anasjelltas: a) ll > 1: **luc** (< llucë) **māndāl** (**mānal** B. < mandall); b) 1 > ll: **bluz**, **kapelo**, **llaps** (< laps), **palc** e **vapës** (< palcë), **pllaçka** (< plaçka), **plan**, **qillo**, **sulltiash** (sualtiac)¹².

§ 24. — Para bashkëtingëlloreve të zëshme fishkëllonjësja z, qoftë si parashtesë, qoftë si tingull i thjeshtë, është shndërruar në afrikaten **x** (z > x): **xath** (B.N. = zbath), **xbegu**, **i zbërdhuqur**, **xbuloj**, **xburak**, **xbut**, **xgarbua**, **xjebe**, **xidh** (< zgjidh), **xjoj** (< zgjoj), **xarris** (< zvarris), **xerku** (< zverku), **xoli** (< zvoli), **maxgall** (< mazgallë), **muxg-a** (< muzg), **pixmos** etj. Në njerëzit e shkolluar edhe të dalë ndihen edhe raste me **z**: **zgjedha**, **zjebe**, **zvol**.

Grupe bashkëtingëlloresh.

§ 25 — Lidhur me zhvillimin fonetik të grupeve bashkëtingëllore **mb**, **nd**, **ng**, **ngj**, **kjo** e folme nuk paraqitet unike.

I — Në Piqeras dhe Nivicë grupet **mb**, **nd**, **ng** janë ruajtur në çdo pozicion qofshin: a) **mbaj**, **mbjell**, **mbraz**, **ndrishoj**, **nduk**, **nga**, **ngre**, **ngri-set** etj.; b) **i ëmbël**, **dimbëdhjet**, **kumbisem**, **mëndak**, **mëndër**, **mingona**, **shtrunga** etj.; c) **dhëmb**, **humb**, **ergjënd**, **shkund**, **tund**, **shtëmbëng**, etj.

Në këto dy fshatra vetëm në parafjalën ndë grupi **nd** në shumicën e rasteve është asimiluar në **n**: mori kondismën **ndë** dor dhe vate në shkoll tek ajo/, e la në hoborr/, vate gruaja në shtëpi/ etj.

II — Në Borsh grupi **mb** > m në çdo pozicion: a) **mit**, **mleth**, **mras** (< mbraz), **mjell** etj.; b) **cimith**, **këm**, **pamuk**; c) **dhëm**, **bum**, **pëllum**, **shkëm** etj.

Grupi **nd** ka dhënë një tingull paragjuhor hundor të zëshëm (do të transkriptohet me shenjën **ñ**). Për shqiptimin e këtij tingulli aparati i të folurit vihet në pozicionin e shqiptimit të tingullit **d**, dmth. maja e gjuhës mbështetet në dhëmbët dhe në alveolet dhe mbyll mirë hapësirën e gojës; ajri pasi gjen një pengesë të papërshkueshme, kalon i tëri në hapësirën e hundës me një forcë më të madhe se në rastin e shqiptimit të tingullit **n**: a) **i neruar**, **nih**, **nrishe** etj.; b) **anej**, **henek**, **kanile**, **snuq** etj.; c) **tën**, **tun**, **vën** etj.

Grupi **ng** është shndërruar në një tingull pasgjuhor hundor të zëshëm (do të transkriptohet me shenjën **ŋ**). Për shqiptimin e tingullit **ŋ** aparati i të folurit vihet në pozicionin e shqiptimit të tingullit **g**, dmth. pjesa e pasme e gjuhës prek qiellzën e butë; ryma e ajrit, pasi nuk gjen shteg

12) Alternimi i tingujve I e II vérehet edhe në Vila Bedessa, po jo aq I:II sa II:I: **nëlnjë** (< mëllënjë), **petulat** (< petullat), **Stambolit** (< Stambollit); **follezë** (< folezë).

Sipas M. Lambertz në V.B. ndihen dy lloje I: a) I, ndofta një tingull likuid anësor palatalveolar si ai që ndihet në Piqeras e në të folmet e tjera të Shqipërisë dhe që është regjistruar përveç në shembujt e dhënë më sipër edhe në këta: **birbil**, **destemel**, **pleqëris**, **stolisure**, **ndolisure**; dhe b) I', tingull likuid anësor palatal, që haset në disa grupe të folmesh arbëreshe të Italisë: **ll'etë-ll'etë**, **bel'anë**, **l'umi**, **mbul'ova**, **kal'in** etj.

për të kaluar në hapësirën e gojës, drejtohet e tëra për në hapësirën e hundës: **ηallohet, ηa, ηordhi, nrë** etj.; b) **hëηra, këη, shtrëηoj, shtruη** etj.; c) **lëη** etj.

§ 26. — Në Piqeras dhe Nivicë grupi **ngj** është shndërruar në **njgj**: nazalja **n** nën ndikimin e **gj** është palatalizuar e është bërë **nj**: a) **njgjallu, njgjiej**; b) **shënjjinës, konjgjill**; c) **qënjgj** etj.

Këtu grupi **ngj** > **nj** në fjalën **njera** (< **njgjera** < **ngjera** < **gjera**, **gjer**): vate **njera** në mes të udhës/, **njersa** ju afrua shtëpis. ja mësoi të tëra/.

Në Borsh zhvillimi fonetik i grupit **ngj** ka shkuar më tej, deri në **nj**. Më duket se kjo **nj** (< **ngj**) shqiptohet me një intensitet më të madh se **nj** e zakonëshme, gjë që ndikon në nazalizimin e zanores që vjen pas saj: a) **njållem, njësh**; b) **konjill, mënjës, shënjjinës, c) qënj** etj.

Shndërrimet **mb** > **m**, **nd** > **n**, **ng** > **η** dhe **ngj** > **nj** janë fenomene më të hershme në krahasim me fenomenin e shurdhimit të bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalës, sepse në rast të kundërt nuk do të kishim këto rezultate për grupet **mb, nd, ng, ngj**, në pozicion në fund të fjalës, pra nuk do të kishim: **shkëm, vën, lëη, po shkëmp, vënt e lënk**.

§ 27 — Grupet **kl** e **gl** në dallim nga çamërishtja janë shndërruar në **q** e **gj**: **qaj, qiç** (kyç), **qish** (kishë) etj.; **gju, gjisht** etj.

§ 28. — grupi **fsh** ruhet kudo. Po në ndonjë rast **fsh** > **psh**: **qënkej pshehur**/ (B.) të **mpshehura** (N.), ndërsa **fsh** > **fj** në **fjes** (< **fshešë**).

Fenomene fonetike

§ 29. — **Shurdhimi**.- Për të folmen e Piqerasit dhe të Nivicës është karakteristik mosshurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në fund dhe në mes të fjalës para bashkëtingëlloreve të shurdhëta.¹³⁾ Në Borsh përkundrazi, me përjashtim të disa rasteve, ato shurdhohen.

a) Në fund të fjalës: **elb, dhëmb, ergjënd, tënd, i madh, mbledh, breg, djeg, xbeg, qënjgj, zogj, ckillav, mez, neqez, njerëz** etj. Në Borsh: **gardhi — garth, vidhi — vith, burgu — burk, pellgu — pellk, i zogje — zog, ckillavi — ckillaf, brezi — bres, Elmazi — Elmas** etj. Këtu nuk janë shurdhuar vetëm bashkëtingëlloret e zëshme fundore, që bëjnë pjesë në grupet bashkëtingëllore **mb, nd, ng, ngj**, sepse janë asimiluar para se të vepronte ligji i shurdhimit.

Gjithashtu nuk shurdhohen bashkëtingëlloret xxxxxxxxxxxx e zëshme, që bëhen fundore pas rënies së zanores ë: e ka **lidh, jam nodh**, është **djeg, vlezhg, llonxh, mrezh** etj.

b) Në mes të fjalës: të **hedhç, u mblodhç, mbluadht, u djegt, të hëngça, u ndezt, rizt** etj. Në Borsh: **erthtin, të hethç, hothtin, trathti** etj. Këtu ruhet shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme edhe para tingujve nazalë **m** e **n**: **dojm** (< **doqmë**), **dojn, hothm** etj.

Në disa fjalë kemi zëvendësim të pakondicionuar të bashkëtingëlloreve të zëshme me korespondueset e tyre të pazëshme: **kabim** (N. < **gabim**), **kurbet** (< **gurbet**), **çade** (P < **xhade**), **siçade** (P. < **sixhade**), **kapshi** (P. = **kamzhik**). Në disa fjalë të tjera, me sa duket, të hyra këtu në formën e shqiptimit të tyre në folme të tjera të toskërishtes, shurdhimi i bashkëtingëllores fundore është ruajtur gjatë gjithë fleksionit të

13) Në të folmen e Vila Badësës gjithashtu nuk shurdhohen: **breg, brez, korb**.

fjalës: **burk** — **burkun** (P. < burg), **sorkath** — **sorkathin** (P. < sorkadh), **tok** — **tokun** (N. < tog).

§. 30. **Sanorizimi**: Në pak fjalë vërehet fenomeni i kundërt, sanorizimi i bashkëtingëlloreve të shurdhëta, i cili në ndonjë rast mund të jetë rezultat i një asimilimi të pjesëshëm ose i një disimilimi: **xhabok** (P. < çapok), **xhurate** (< çorap), **i rrevgët** (P. < i rrefkët), **ibrig** (N. < ibrik), na **gërdisi** (N. < kërdisi), **gëlbaz** (< këlbazë), **godosh** (< kodosh), **gërmill** (< kërmill), **protogale** (P. < portokale), **tërguz** (P. < tërkuzë), **bedrav** (B. < petravë), **katogj** (N. < katoq), **Budrintua** (N. < Burtintua), **pregaditi** (P. < pregatiti), **sod** (N. < sot).

§. 31. **Asimilimi**: Ky fenomen nuk është aq i shpeshtë, sidomos në grupe bashkëtingëlloresh, sa në të folme të tjera të toskërishtes.

Po renditim disa shembuj asimilimesh:

A) — Asimilime vokalice: a) progresive: **bisi-loj** (N. < bisedoj), **nofoll** (B > **nofull**); b) regresive: **qaramidhe** (B. < qiramidhe), **enderes** (N. < interes), **rovolet** (P. < revolet). **budrun** (B. < bodrun), **rrutulloj** (N. < rrotulloj), **suguronej** (P. < siguronej).

B) — Asimilime konsonantike: a) progresive: **kasnjëdidës** (P. < kasnjëditës); b) regresive: **gjërpër** (N. < gjëlpërë), **mumbak** (P. < pumbak).

C) — Asimilime konsonantike të pjesëshme: a) dy buzorja **p** në Borsh dhe Nivicë para anazales **n** asimilohet në **m**: **t i imni** (< ipni), **e hamn** (< hapnë), **hamnie** (< hapnie), **mo e rimni** (< ripni) etj. 14); b) para nazales **n** grykorja **k** asimilohet në të zëshme **e** saj **g**: **iηn** (B. < inknë) < iknë), **miηn** (B. < miknë), **u plaηn** (< plaknë); c) pjesëza mohonjëse **s** para bashkëtingëlloreve të zëshme asimilohet në **z**: **z dalëm/**, **z gatua j dot/**.

C) — Asimilime në grupe bashkëtingëlloresh: këto hasen rrallë, janë si të thuash relikte, sepse sot me zëvendësimin e mbaresës **-në** me **-in**, **-un** dhe **-ën** janë zhdukur kushtet për realizimin e këtij fenomeni: **dhn** > **dh**: **erdh** (< erdhnë), **hodh**, **mbluadh**; **lln** > **ll**: **duall** (< duallnë); **rn** > **r**: **muar** (< muarnë). Më i shpeshtë është asimilimi i grupit **tn** > **n**: **flini** (< flitni), **u fun** (< futnë), **man** (< matnë), **këpun** (< këputnë), **mea** (< mbetnë). Shumë rrallë **tn** > **m**: **gjem** (< gjetmë).

§. 32. — **Metateza**. Haset gjithashtu rrallë: **bedrav** (B., **petrav** — N. < **petavër**), **gjetëk** (P. < **gjetkë**), **mëndroj** (P. < **mëndroj** < **nëmroj** < **nëmëroj**), **lëvoj** (B. < **valo j**), **e njëte** (P. N. < **e ënjte**), **prevas** (B. < **parvaz**), **protogale** (P. < **portokale**), **qiprik** (B. **qerpik**), **trëndafil** (N. < **trëndatil**), **trutull** (B. < **turtull**); **vlezhg** (B. < **lëvezhgë**).

§. 33. — **Fenomeni i shtimit të tingujve**. A) — Në fillim të disa fjalëve që nisnin me zanore herë shtohet një **j** e herë jo: **i jati**, **e jëma**, **t i jape**, **s u jip**, po më shumë: **i ati**, **e ëma**, **s t apën**, **po kush t ip/ etj**.

B) — Në mes të fjalës më shpesh shtohet tingulli **b** pas **m** dhe **d** pas **n**: **mbjel** (P. < **mjel**), **mbjekër** (< **mjekër**), **mbretja** (P. < **mërete**); **kondisma** (< **konizma**), **ndallane** (< **nallane**). Në kallzoren njëjës të disa emrave që mbarojnë me bashkëtingëlloren **k**, dhe në të kryerën e thjeshtë veta e III shumës të foljeve që gjithashtu mbarojnë me **k**, shtohet para **k** tingulli **n**. Ky fenomen më tepër se një shtim i thjeshtë është një atrakcion, sepse çfaqet në rastet kur trajtat e përmendura marrin mbaresën

14) Në Vila Badessë **p** asimilohet edhe para **m**: **emmë** (< **epmë**).

-n(ë): **mi**ηη (B. < minknë < miknë). **i**ηη (B. < inknë < iknë), **u** plaηη (B. < u plaknë). Tinguj të shtuar ka dhe në këto raste: **qender** (P. < qeder), **zangal** (P. zegali) **çallti** (P. B. < çati), **mamuzer** (P. < mauzer), **palça** (B. < paça), **cimilar** (B. < smilar), **kilikaz** (B. këlkazë).

Një j epentetike antihiatizuese zhvillohet para nyjës shquese në emrat femërorë që mbarojnë me a dhe e. Në emrat femërorë me e të patheksuar shpesh sidomos kur mbas rënies së e, tingulli j ndodhet pas palataleve **q e gj** j shndërrohet në i; ndërsa në emrat me e të theksuar j herë shtohet e herë jo (lëkundja është më e theksuar në Borsh): **bodil (e) -- j-a**; **nus(e)-j-a, sepet(e)-j-a etj.**; **koq(e)-i-a, patiq(e)-i-a, qiq(e)-i-a, magj(e)-i-a, vegj(e)-i-a, gjul(e)-i-a**; **kapné-ja, podhé-j-a**, po edhe: **kahvé-a, xhezvë-a**. Në emrat femërorë, që mbarojnë me i, para nyjës a nuk shtohet j: **fuqi-a, kusi-a, pirosti-a** etj. Edhe në urdhënoren e foljeve me temë në zanore (veç jo tek ato me zanoren o) shtohet një j antihiatizuese midis temës dhe trajtës së shkurtër enklitike e ose pjesëzës së trajtës pësore **u: leje, preje, pije, zeje, laju** etj.

C).- Në fund të fjalës: **gjumb** (P. gjum = gjym).

§ 34.- **Fenomeni i rënies së tingujve.** — Në fillim të fjalës bie më të rrallë ndonjë tingull si: **astëk** (B. < jastëk), **dërtoj** (< ndërtoj), **gadal**, (< ngadal), **shtit** (< tështit).

Në mes të fjalës bie rregullisht tingulli v pas afrikatave x e xh: **xarris** (< xvarris), **xerk** (< xverk), **xol** (< xvoll), **Ixuar** (< I xuar), **xhesh** (< xhvesh). Në gjindoren e dhanoren e emrave patronimikë me -aj (< anj) ka rënë tingulli j, gjë që ka dhënë rast për kontraktimin e zanoreve ae: isht i **xhane** (< i xhanaje), i **çune** (< i çunaje), **çorre** (< i çorraje) etj. Bien gjithashtu edhe tingujt s e sh para afrikates ç: të **ngaç** (< të ngaçç), të **preç** (< të presieç), të **qiraç** (< të qirasc), të **vrac** (< të vrasç), të **pric** (< të prishç.) etj. Po vëmë në dukje edhe ndonjë rast tjetër: **curk** (< sfurk), **rëkoj** (< rënkvoj), **xath** (B. N. = xbath).

§ 35. — **Kontraktimi i zanoreve.** Togu i zanoreve ae, që lind në gjindoren e emrave patronimikë dhe në urdhënoren e disa foljeve, kontraktohet në e; te Kroj **çeçe** (< ceçaje), qëni **ndrere** (< ndrera e < ndrerraje), **vre** (B. < vrae) etj.

Gjithashtu kontraktohet në e togu oe, që formohet në urdhënoren e foljeve me -oj, kur u shtohet pas trajta e shkurtër e përemrit / e: **fërke** (< fërkoe), **gërmë** (< gërmoe), **pune** (< punoe) etj.

Togu ëe, që formohet nga ë e pjesëzës të e kohës së ardhme, e lidhore, e kushtores dhe e paskajores dhe trajtës së shkurtër e, zakonisht nuk kontraktohet në a si në shqipen e përbashkët: t e bëç, ja t e zëm/, ku t e gjën kufin/, do t e vën/, do t e marrç/, po rrallë dhe: do veje ta shesje/, do ta marrë etj.

Togu ëe, që lind nga bashkimi i trajtave të shkurtëra më e, në ato pak shembuj që kam regjistruar, del i kontraktuar në a: mo **ma** thuj mua/, **ma** çori/, **ma** jep mua!

§ 36.- **Elizioni:** Zanorja ë në fund të fjalës (në ato raste që ruhet në këtë të folme) bie sa herë që fjala pas saj fillon me zanore: ka të thot **q e** kemi ndrishuar/ (< që e...), **m i** ligu (< më i...), **q u** doq (< u...).

Nën ndikimin e nyjës së përparme e bie nyja shquese **a**: **are** qesare (< ara e...), **lulje** bardh (< lulja e...) **mbuloje** çobanit (< mbuloja e...), **nusje** madhe (< nusja e...) etj.

Nyja e përparme **i** pas emrash në trajtën e shquar nuk ndihet: **djali** mbretit (= djali i...), **kali** kuq (= kali i...), **Vështi Shore** (= Vështi i...) etj.; **fiku** zi (=fiku i...), **laku** atij(=laku i...), **m** i ligu vëllëzërve (= ... ligu i...), **parmaku** portës (= parmaku i...), **shoku** këtia (= shoku i...), po (sidomos në Borsh) edhe: **Bregu** i Caushit, **Lugu** i Sheshez, **peshku** i kurrizit (14).

MORFOLOGJIA

Emri

§ 37.- **Gjinia e emrit.** — Në gjendjen e sotme të zhvillimit të kësaj së folme gjinia asnjëse ende ruhet mirë, sidomos në emrat që tregojnë lëndë: **brumët**, **djathët**, **dhjamët**, ata **grurët**, **gjalpët**, **lesht**, **miellt**, **misht**, **plët**, **qumështit**, **rizt**, **vajt** etj. **Brezat** më të rinj, ndërsa rrallë **brezi** i vjetër, kanë prirjen t'i kthejnë në emra të gjinisë mashkullore dhe femërore: **gjalpi**, **leshi**, **mishin**, **plëri**, **rizi**, **vajin**, etj.; **dhalla** (B.) **Del** në gjininë asnjëse dhe emri **ballt** (B): **vrava ballt**/.

Hasen më të rrallë dhe emra asnjëse të ardhur nga foljet e mbiemrat: **kan** qën në të **branisur**/, **vate** në të **lar**/, **qe** të mir ata të **puthur**/, të **qethurit**, të **largët** etj.

Disa emra të gjinisë mashkullore e kanë ndërruar gjininë dhe janë bërë femërorë: **dhelfina** (P. delfini), **gjaja** (gjahu), **gjalma** (gjalmi), **ilitrika** (elektriku), **harca** (harci), **xhamja** (N. xhami), **xhurapja** (çorapi).

Janë të gjinisë mashkullore emrat e mëposhtëm: **buti** (butja), **eti** (B. etja), **fasuli** (P. fasulja), **kasmai** (kazmaja), **kotolli** (kotulla), **sufrai** (sufraja), **tumëni** (B. tumania). Emrat që mbarojnë me **o** të theksuar (emra të huajtur nga greqishtja), janë mashkullore: **astakoi**, **koftoi**, **vasiliko**, **skorpjo** etj.

§ 38. — **Emërorja.** Emrat që në shqipen e lashtë mbaronin me **n**, e nxjerrin këtë kur shquhen (në njëjës të rotacizuar, në shumës të nallatizuar): **bri**, **kalliri** (N.), **mulliri**, **përi**, **qiviri** etj., po edhe **briu** (P. krahas **briri**), **kalliu** (P.), **kushëriu**, **qiriu** (N.). Gjatë paradigmës shtohet një **r** edhe në emrat **plë** e që: **plëri**, **qëri**, **qëre** etj.

Emrat që mbarojnë me **-uar**, kur shquhen, e kthejnë ua > o: **mëzuar** - **mëzori**, **përçuar** - **përçori**, **puntuar** - **puntori**.

Emri **vëlla**, kur shquhet, merr njëjën **u**: **vëllau**, ndërsa në Nivicë edhe **vëllai**.

§ 39 — **Shumësi i emrave. Shumësi i emrave mashkullore:** a) Një nga mbaresat e përhapura në formimin e shumësit të emrave është mbaresa **-ë**, e cila, si fundore, sot nuk ndihet. Trajta e shumësit dallohet nga trajta e njëjësit nga kuantiteti i zanores së theksuar, e cila në njëjës është ose e gjatë ose e shkurtër, ndërsa në shumës e mesme. Në krahasim me të folmen e Përmetit e Zagorisë gjallëria

14) Në Vila Badessa: «Ti i pari valles, / si bishti gomarës! / Lëngu i dhr.s, / Bastuni pleqëris!», zogu i par etj.

e mbaresës -ë nuk është dhe aq e madhe. E marrin këtë mbaresë në shumës një pjesë e mirë e emrave mashkullorë, që mbarojnë me një bashkëtingëllore pas zanores së theksuar dhe që emërtojnë përgjithësisht sende: kallamār — kallamar, krobūr — krobur, poçār-poçar, astĕk — astĕk — çarçāf — çarçaf, farasĕān — farashan, filxĕān — filxhan, jatak — jatak, kabāsh — kabash, kapās — kapas, masĕān — mashan, tallagān — tallagan, xĕābok — xhabok etj.

Janë të pakët emrat mashkullorë, që emërtojnë frymorë dhe që marrin mbaresën -ë në shumës: kiçār — kiçar, qukapīk — qukapik, sheļĕg-sheleg etj.

b) Mbaresë -e, në krahasim me disa të folme të tjera të toskërishtes, këtu ka një gjallëri më të madhe: çengel-e, gjumb-e, fol-e, fron-e, kazan-e, kosh-e, kotec-e, mën-e, pogon-e, qebap-e, që-r-e, qup-e, tigan-e, vidh-e, xol-e, xhup-e etj.

Mbaresë -e përdoret shpesh si mbaresë e dytë në emrat që e bëjnë shumësin me palatalizimin e bashkëtingëlloreve fundore (shih më poshtë).

c) Disa kategori emrash e bëjnë shumësin me palatalizimin e bashkëtingëllores fundore, që është rezultat i ndikimit të mbaresës -i të vjetër, e cila me kohë ka rënë (Këta emra janë fjalë të vjetra të shqipes. Emrat e huajtur nga turqishtja etj. ose të formuar rishtas nga brumi i gjurës, që mbarojnë me bashkëtingëlloret k, g, ll ose me zanore, marrin në shumës zakonisht mbaresë të tje.a. po një pjesë e tyre e bëjnë shumësin për analogji me palatalizimin e bashkëtingëllores fundore).

E bëjnë shumësin me palatalizim:

1) Emrat që mbarojnë me **k, g**. Në shumës $k > q$ dhe $g > gj$: bujk-bujq, fik fiq, pishk-pishq, ujk-ujq (B. uqij — P., uqëre — N) zog-zogj. Sot shumica e këtyre emrave, veç kësaj, ose marrin mbaresë të dytë, ose metafonizojnë zanoren e rrënjës ose dhe njerëz dhe jetrën: curk — curqe, dufek-dufeqe, durek-dureqe, tevlik-tevliqe, xerk — xerqe, dhrong — dhrongje, ibrig — ibrigje, pellk — pellgje (B), vig — vigje; plak — pleq; bark — berqe, lak — leqe, thark — therqe, xburak — xbureqe (B.), vark — vergje (B.) etj.

2) Emrat që në njësin e pashquar kanë pasë mbaruar me **-n**. Në shumës **-n** nën ndikimin e mbaresës **-i** është shndërruar në **-nj**, e cila herë herë ndihet dhe **-j** (shih § 16): ftua-ftonj, thua-thonj, hu-hunj, kushëri — kushërinj, mulli — mullinj, pë-pënj etj. Disa të tjerë marrin edhe mbaresën **-e**: përrua — përronje (N., përrënj — B., përrënj — P.), sorua — soronje.

Në analogji me emrat e tipit «mulli» e bëjnë shumësin, duke marrë **-nj**, edhe emrat që mbarojnë me zanore të theksuar jo nazale: bekshi-bekshinj, çilimi — çiliminj, peshli — peshlij, shapi — shapinj, ulli — ullij. Emra të kësaj kategorie dalin në shumës edhe me një trajtë të njëjtë me atë të njëjësit: mi — sh. mi, arixhi-sh. arixhi, bekshi — sh. bekshi, peshli — sh. peshli, shapi — sh. shapi, ulli — sh. ulli etj.

3) Emrat që mbarojnë me **-ll**. Në shumës **-ll** shndërrchet në **j**, e cila në disa raste për analogji me shumësat me **-nj** ka dhënë **nj**: brumbull — brumbuj, gërmill — gërmij, kaptell — kaptej, konjgjill — konjgijj, kshieļ — kshiej, trutull — trutuj, xgarbull-xgarbuj etj. Disa të tjerë marrin edhe mbaresë, ose metafonizojnë zanoren e rrënjës: hell-heja, ill — ija,

pill — **pije**; çakall — **çakej** (B., **çakenj** — P.), mashkull — **meshkuj** (**meshquj** — B.), strrall — **strrenj** (N.).

Në analogji me këta e bëjnë shumësin, duke ndryshuar në **j** e **nj** bashkëtingëlloren fundore, edhe këta emra: cinxur — **cinxuj**, lepur — **lepuj**, lostar — **lostenj** (N.) vetul — **vetuj** (N.) pshal — **pshenj** (N.).

ç) Në këtë të folme, sidomos në Nivicë, hasen mjaft emra që në shumës metafonizojnë zanoren e rrënjës. Po si mjet i vetëm për formimin e shumës metafonizimi haset në pak raste; më shumë ai përdoret si mjet i dytë krahas mjeteve të tjera, që janë primare: a) **cjap-cjep**, **ckllav-ckilev**, **dash-desh**, **kunat-kunet**, **kunav-kunev**, **zorkath-zorqeth**; b) **çakall-çakej**, **andër-endre** (N.) **dullap-dullepe** (N.), **gardh-gjerdhe**, **mashkull-meshquj**, **stan-stene**, **talër-telëre**, **trap-trepe** (N.) etj.

Në pak raste emrat që e bëjnë shumësin me metafori, marrin dhe mbaresë të dytë: **maç-mecër**, **shat-shetër**.

d) Një kategori emrash të tjerë e bëjnë shumësin me mbaresat **-ij** (< -inj) dhe **-ënj**: **bosht** — **boshtij**; **lum-lumënj**, **shkëmb-shkëmbënj**, **drapër** — **drëpënj**, **gjarpër** — **gjërpënj**, **varg vërgënj** (N.).

e) Jo rrallë haset këtu mbaresa **-ër**. E marrin në shumës këtë mbaresë sidomos emrat që tregojnë frymorë, ndërsa haset rrallë në emrat që tregojnë sende: a) **bic-bicër**, **buf-bufër**, **burith-burithër**, **gushkuq-gushkuqër**, **karkalec-karkalecër**, **kulish-kulishër**, **larash-larashër**, **lab-labër**, **mëzak-mëzakër**, **nip-nipër**, **prift-priftër**, **prind-prindër**, **rrieth-rriethër**, **viç-viçër**; b) **gjisht-gjishtër**, **katoq-katogjër**, **qiç-qiçër**, **thes-thesër** (N.).

Kur shquhen, marrin para njëjës **-t** zanoren anapititike **i**, ndërsa zanorja **e** para **r** rrallë bie: **larashërit**, **kulishërit**, **kecrit** etj.

ë) Emrat mashkullorë veprojnë me prapashtesën **-ës** zakonisht nuk e ndërrojnë trajtën në shumës: **ardhës** — sh. **ardhës** **lugës** — sh. **lugës**, **qepës** — sh. **qepës**, **shtipës** — sh. **shtipës**. Kur shquhen, marrin para njëjës zanoren anapititike **i**: **ardhësit**, **lugsit**, **qepsit** etj. Më të rrallë mund të marrin edhe mbaresë: **ballës-ballsa**, **çitës-çitësa**, **djepës-djepse**.

f) Për t'u vënë në dukje janë dhe shumësit e këtyre emrave: emri «qëngj» e bën shumësin me rrënjë tjetër: **shtjerra**, po në Borsh edhe **qënja**; **vësh-vresha**; emri «djal» e bën shumësin e pashquar **djem**, ndërsa të shquarin **djelt**; emri «frëth» (< frë-th) e bën shumësin në Piqeras **frëthe**, në Borsh **frënja**; emri «kal» e bën shumësin në Nivicë **kuaj**, kurse në Borsh **kual** dhe **kelt** e **qiqes**.

Shumësi i emrave femërorë. a) Emrat femërorë të prejardhur me prapashtesën **-j** (**ë**) e bëjnë shumësin me mbaresën **-a**: **karthij** - **karthija**, **mbërthekij-mbërthekija**, **plasi-j-plasija**, **përparij-përparija**, **vdekij-vdekija** etj.

b) Në Nivicë disa emra femërorë, që mbarojnë me **e** të theksuar, e bëjnë shumësin duke ndërruar **e**: **i** dhe duke marrë mbaresën **-a**: **folë-fofia**, **rrë-rria**.

c) Shumësi i emrit «vajz» është **vashas**.

§ 40.- **Kallzorja**: Emrat mashkullorë, që mbarojnë në trajtën e pashquar me zanore, e formojnë trajtën e shquar të kallzores nga trajta e pashquar, së cilës i shtohet mbaresa — njëjës **-n(ë)**; **gju-gjun**, **kërci-kërcin**, **mulli-mullin**, **si-sin**, **sufra-sufiran**, **thua-thuan** etj. Në Borsh hasen edhe trajta të kallzores së shquar të formuara nga një trajtë analoge me trajtën e emërores së shquar dhe me mbaresën-nyjë **-n(ë)**: **kufiri-kufirin**, **shapiu-shapiun** etj.

Emrat që mbarojnë në trajtën e pashquar me bashkëtingëllore, e

formojnë trajtën e shquar të kallzores nga një trajtë analoge me atë të emërores së shquar, së cilës i shtohet mbaresa-nyjë **-n(ë)**: **gropi-n, jorgani-n, keci-n, plori-n, urori-n, barku-n, laku-n, shtegu-n** etj.

Trajta të tilla si: **inat-inan, mik-miηⁿ, nam-namn**, janë të rralla, relikte që ndihen ende në sajë të fenomeneve fonetike të shkakëtuara nga prania e mbaresës-nyjë **-n(ë)**.

§ 41.- E ashtuquajtura rasë vendore në këtë të folme nuk përdoret, po në Borsh hasen disa trajta rasore me karakterizuesen **-t** me një përdorim shumë të kufizuar, të paraprirë nga parafjalët **në** e **më**: do vihej thika e buka në **mest/**, e **η**tërron në **mest/**, i bëj tok në **shesht/**, pup **π**ëiti mu në **shesht/**, më **darkët**.

§ 42.- **Trajta e gjindores, dhanores dhe rrjedhores shumë**s. Emrat që mbarojnë në shumë me bashkëtingëllore (veç atyre që bëhen të tillë pas rënies së mbaresës **-ë**), marrin në gjindore, dhanore e rrjedhore mbaresën **-e**: do thom një këng të **birbilenje/**, nga të **deshe**, lloit e **fiac**. në mes të **ullinje**, kish marr udhët e **uqëre/** çobani **dhëne**, jan të **vashaze**: u shpum çpërblim **miqe/**, u thomi **zogje/**. Emrat patronimikë (si **corraj, çuanj, zeqiraj** etj.) e bëjnë shumësin e këtyre rasave duke bjerë i e mbaresës **-aj**: e nji atë të **çoraē/** (P.); në shumicën e rasteve togu zanor **ae**, që formohet, kontraktohet në **e**: nuk flasëm gjun e **core/**(P.). te Kroi **Çeçe**, Shpelle **Çune**, mi atë të **zeqire** etj.

Sot në shumicën e rasteve trajta e shquar nuk dallohet nga trajta e pashquar, po aty këtu në Borsh edhe dallohet: **η**a lesh të **dhënet**, u thoshëm atire të **vogjijet/**, karshi **prinëret** etj.

Nyja

§ 43. Në këtë të folme si nyjë e përparme pas emrash femërorë të shquar rasa gjindore dhe dhanore përdoret nyja **e**, e cila është një shtrirje analogjike e nyjës së përparme të rasës emërore gjinia femërore: përpara bangos e t akuzuare, ditën e **pashkës** e gushtit, di atë kënën e luftës e Vlorës, në koh t Italis e par, e vë në sis të mëmës e tia/ etj.

Kjo analogji ka shkuar edhe më tej në P. e N., sepse edhe pas emrash mashkullorë të shquar rasa gjindore dhe dhanore përdoret **e**: i bën djalit e mbretit/, vajze djalit e madh. Po, nëqoftëse pas emrave femërorë analogjia është përgjithësuar kudo (nuk kam ndeshur asnjë rast të kësaj kategorie, ku të mos jetë përdorur nyja e përparme **e**), pas emrave mashkullorë kjo analogji s'është përgjithësuar, veç në disa shembuj që, në bazë të materialeve të mbledhura, përbëjnë një masë të vogël.

Në shumicën e rasteve pas emrash mashkullorë në gjindore e dhanore të shquar nuk ndihet nyjë e përparme: të babit Hakes, vëllait vogël, nga të deshe mëdhënj, isht e burazerve mi/, u thot plaku shokëve tia/, nga të shokëve tu etj.

Në Nivicë kam dëgjuar edhe dy raste, ku pas emrash në rasën kallzore trajta e pashquar është përdorur, si edhe në rastet e më sipërme, nyja e përparme **e**: mbeti në klas e dit/, do shpiem një lir e verdh/.

Për t'u vënë në dukje është dhe përdorimi i emrave patronimikë si dhe i emrave që tregojnë banorin e një vendi në rasën emërore njëjës të nyjzuar, ndërsa në shumë pa nyjë: i **vovlataj**, i **spiraj**, i **xhanaj**, i **likovjot**, i **delvinjot**, i **piqeras** etj. në shumë: **vovlatajt**, **xhanajt**, **lokoviot** etj.

Mbiemri

§ 44. Lidhur me mbiemrat nuk do të zgjatëm, sepse nuk paragonim ndonjë interes të veçantë dialektor, do të përmend vetëm shumësit e disa mbiemrave që dallohen nga toskërishtja e përbashkët. Mbiemri «i madh» e bën shumësin të mbëdhënj (të mëdhënj — B.), fem. të mëdha; «i vogël» të vogjij, fem. të vogëla. Shumësi i mbiemrave fem.: «e re», «e ve» bëhet në Borsh me apofoni: të ra, të va, ndërsa në Piqeras këta mbiemra, si edhe emrat femërorë me -é, e bëjnë duke ndërruar e-i dhe duke marrë mbaresën -a: të ria, të via; shumësi i mbiemrit «i ri» është të rrinj (të rij, të ri). Në Nivicë mbiemrat: «i gjat» dhe «i trash» e bëjnë shumësin me metafoini: të gjet, të tresh.

Përemrat

§ 45.- Përemri vetor. Rasa emërore njëjës ka këto trajta: u, ti, ai, ajo: z dij u t ecij n udh tjetër/, të thom u/. Në Piqeras për vetën e tretë kam dëgjuar edhe trajtën ain: vate shtat ain/.

Rasa dhanore e kallzore e vetës së dytë ka trajtën tia: të thoshij tia/; në mos mua, tia/; për tia isht/.

Rasa emërore shumësi ka për vetën e I trajtat: na, nevet (neve). Trajta na përdoret zakonisht pas foljes, ndërsa nevet (neve) zakonisht para saj: thomi na/, na, do lozëm na/, shkalet thomi na/, do vish nga na/; nevet i themi.../, nevet jemi kaza e Sarëndës/, nevet jemi vëndës/, neve borshit/. Po hasen dhe raste të kundërta: do flini ju, që t'i kuptojmë nevet /, na që kemi fol/ etj. Për vetën e II-të shumësi kam ndeshur vetëm trajtën ju: që thoi ju/, ku kini qën ju? etj.

Rasa dhanore shumësi ka trajtat: veta e I neve (nevet), veta e II juve (juvet). Trajta e shkurtër e vetës së II është u: duam kaq napolona, i djelt do t'ua vrasëm/.

Rasa kallzore shumësi ka trajtat: veta I ne (nevet, neve): erdhi me ne/, do bish me ne/, pieni neve që z dim/; veta e II ju (juvet, juve): do rri me ju/, është keq për juvet/.

§ 36.- Mbiemri pronor:

		Veta e I		Veta e II	
		Gjin. mashk.	Gjin. fem.	Gjinia mashk.	Gjinia fem.
Pronari njëjës	Prona njëjës	plaku im, plakut tim plakun tim	shtëpia ime shtëpis time shtëpin time	plakut it plekut tënd (tē _n -B) plakun tënd (tē _n -B)	shtëpia jote shtëpis tēnde shtëpinē tēnde- (tē _n e-B).
	Prona shumësi	plejt e mi pleqe mi	shtëpit e mia shtëpive mia	plejt e tu pleqe tu	shtëpit e tua shtëpive tua
Pronari shumësi	Prona njëjës	plaku in plakut tēn plakun tēn	shtëpia jon shtëpis ton shtëpin ton	plaku juaj plakut tuaj plakun tuaj	shtëpia juaj shtëpis tuaj shtëpin tuaj
	Prona shumësi	plejt tan pleqe tan	shtëpit tona shtëpive tona	plejt tuaj pleqe tuaj	shtëpit tuaja shtëpive tuaja

Aty këtu në Nivicë dëgjohej edhe raste përdorimi të mbiemrave pronorë para emrave të fafesisnisë: **ime mbes, it at, jot ëm**.

§ 47. **Përemri dhe mbiemri dëftor**. Për t'u përmendur këtu janë trajtat e rrjedhore shumë: **ashish, ashosh, kshish, kshosh** të përemrave dhe mbiemrave dëftorë ai, ajo, ki, kjo: **jo ashish**, të til/, ndonjë **ashish** do haj dhe ai/, të shkruaç **ashosh gjëra/**, a more **kshish?**, **kshish burra** etj.

Rriedhorja e këtyre përemrave dhe mbiemrave dëftorë paraqitet edhe në një trajtë tjetër me **-e**: jo **ashishe** që thua ti/, **kshishe** thua ti?, kish mërëpar **kshoshe/**, me **kshoshe** pllaç mbahemi/ etj. Në bazë të materjalit që kam mbledhur, rezultojnë që trajtat me **-e** janë më të paka në numër. Këto janë trajta analogjike me mbiemra të tipit e kuq-e, e madhe të përhapura në fillim në përdorimin mbiemëror të trajtave femërore për të bërë një dallim të dytë, sepse kuptimi i gjinisë tek trajtat **ashish, ashosh, kshish, kshosh**, paraqitet i dobësuar; sot ka raste që trajtat e gjinisë mashkullore përdoren për femëroren dhe anasjelltas p.sh.: **kshish** gjëra, **kshish** radio, **kshosh** emra do ai/.

Në Nivicë për rrjedhoren femërore kam hasur në dy shembuj dhe një trajtë të tretë: më dhan **ashoje/**, **kshoje** rroba.

§ 48.- **Përemra pyetës dhe të pakufishëm**. Nga përemrat pyetës po përmend: **çili?** (m.), **çila?** (f. — P., N.): **çili** fshat? Rasa kallzore e gjinisë mashkullore është **çil: çil** kërkon?. Trajta e rasës gjindore — dhanore përemrit **kush** është **kuj** dhe **kuja**.

Nga përemrat e pakufishëm po përmend: **gjithçili** (B = gjithkush); **çoç** (N. = diçka): u thom që **çoç** ka/; **tjatër** dhe **tjetër**.

Folja

Trajta veprore

§ 49 - **Mënyra dëftore. Koha e tashme**. Foljet e zgjedhimit të II klase e I¹⁵⁾ në vetën e I njëjës mbarojnë me bashkëtingëlloren **-t: fut, godit, këput, mbit, ngjit, xbut** etj. Kjo **-t** ruhet në të tëra vetat.

Mbaresat e tri vetave të shumësit për foljet në bashkëtingëllore janë: **-ëm, -ni** (dhe **-i**¹⁶⁾, **-ën: këput, këput, këput, këputëm, këpuni** (< këputni) **këputën//, marr, merr, merr, marrëm, merri, marrën//** etj.

Foljet e zgjedhimit të III marrin në shumës mbaresat: **-jëm, -ni, -jën: bëj, bën, bën, bëjëm, bëni, bëjën//** etj.

Sipas tipit të foljeve të zgjedhimit të IV klase e I zgjedhohet dhe folja **mba** (=mbaj). Në shumës foljet e këtij zgjedhimi marrin mbaresat: **-m, -ni** (-i, sidomos foljet e klasës së II, të cilat në këtë vetë dalin me rrënjën e vjetër), **-n: ha, ha, ha, ham, hani** (hai), **han//, shpie, shpie, shpie, shpiem, shpiri, shpien//** etj.

¹⁵⁾ Sipas klasifikimit të K. Cipos në «Gramatika shqipe».

¹⁶⁾ Mbaresa **-i** e vetës së II haset më shumë në foljet, tema e të cilave mbaron në bashkëtingëllore **dh, ll, l, rr**, si: **mlidhi, ndilli, dilli, tirri** etj., po nuk mungojnë dhe rastet, ku ajo përdoret në foljet me temë në zanore si: **doi** (=doni), **hai** (=hani), **thol** (=thoni).

Foljet ndihmëtare: «kam», «jam» si edhe folja «them» kanë në të tashmen trajtat: **kam** (edhe **kamte** — N.), **k e**, **kā**, **kemi**, **kini**, **kan//**, **jam** (edhe **jamte** — N.), **je**, **isht** (është — B.), **jemi**, **ini**, **jan//**, **thom**, (edhe **thomte** — N.P.), **thua**, **thot**, **thomi**, **thoi**, **thon//**. Për t'u vënë në dukje janë trajtat e vetës së I me një zgjerim në -te: **kamte**, **jante**, **thomte**, të cilat hasen dhe në tekstet çame të mbledhura nga Pederseni.¹⁷⁾

§ 50.- **E pakryera**. Si në Zagori edhe në të folmen e Bregut të Poshtëm koha e pakryer dallohet për larminë e mbaresave.

a) Foljet e zgjedhimit të I e të II marrin mbaresat: njëjës: I. — **ij**, II. **-je**, III. - pa mbaresë; shumës: I. - **im** (-ëm), II **-it** (-ët), III. **-in** (-ën). Me këto mbaresë e bëjnë të pakryerën edhe foljet e zgjedhimit të IV klasa e II. po rëndërkaq çfaqet rrënja e vjetër e këtyre foljeve (veç vetës së III njëjës). Foljet e klasës së II të zgjedhimeve të I, II dhe të IV nuk e kthjenë në **i** zanoren e rrënjës (**a**, **e**, **ë**, dhe **je**, **ie**) në dy vetat e para të njëjësit dhe zakonisht në tri vetat e shumësit siç ndodh në shqipen e përbashkët. Mbaresat e dyta të shumësit janë më të rëndomta në Borsh. Në Nivicë ato i kam dëgjuar nga një plakë 88 vjeçare, ndërsa në Piqeras nuk më ka zënë veshi asnjë herë.

çkulij, **çkulje**, **çkul**, **çkulim** (çkulëm), **çkuli** (çkulët), **çkulin** (çkulën)//, **këputij**, **këputje**, **këput**, **këputim** (këputëm), **këputit** (këputët), **këputin** (këputën)//, **dali**, **dalje**, **dil**, **dalim** (dalëm), **dalit** (dalët), **dalin** (dalën)//, **hedhij**, **hedhje**, **hidh** (hith — B.), **hedhim** (hedhëm), **hedhit** (hedhët), **hedhin** (hedhën)//, **presij**, **presje**, **prit**, **presim** (presëm), **presit** (presët), **presin**, (presën)//, **bierij**, **bierje**, **bij**, **bierim** (bierëm), **bierit** (bierët), **bierin**, (bierën)//.

Për këtë kategori foljesh kam dëgjuar në Nivicë dhe Borsh, në pak shembuj, mund të them si relikte, mbaresat **-ë** (veta e I njëjës, **ë** sot ka rënë), **-e** (veta e II njëjës): dojt ta **vërj** (=doja ta vija), **shpier** (=shpija), të **shohe** se ç kos qe **bërj**, (shihje), **vëre** (vije), **shpiere** (shpije).

Në Piqeras për vetën e III të shumësit, në pak shembuj, kam hasur një trajtë me mbaresën **-n(ë)**, që është e rëndomtë në disa të folme të Kurveleshit: **dil** (=dilin), **tirr** (=tirnin), van në mal të **mbill** misër/ (= mbillin), ata po penxheret i kishën t afërta dhe e **shin** sho shoqin/ (=shihnin).

b) Foljet me temë në zanore marrin në të pakryerën mbaresat: njëjës: I — **j** (ë)¹⁸⁾, II. **-je**, III. pa mbaresë¹⁹⁾, shumës: I-**im** (-jëm), II-**it** (-jët), III-**in** (-jën). Mbaresat e dyta mbisundojnë në Borsh, po jo rrallë hasen edhe në Nivicë. Në Piqeras i kam dëgjuar shumë rrallë në krahasim me mbaresat e tjera.

bëj, **bëje**, **bën**, **bëim** (bëjëm), **bëit** (bëjët), **bëin** (bëjën)//, **punoj**, **punoje**, **punon**, **punoim** (punojëm), **punoit** (punojët), **punoim** (punojën)//, **bluaj**, **bluaje**, **bluan**, **bluaim** (bluajëm), **bluait** (bluajët), **bluain** (bluajën)//, **pij**, **pije**, **pin**, **piim** (pijëm), **piit** (pijët), **piin** (pijën)// etj.

Foljet **shoh** e **njoh** në Piqeras e bëjnë të pakryerën: **shoj**, **njoj** me që h si fundore s'ndihet e tema del në zanore, ndërsa në Borsh **shohij**, **njo-**

17) H. Pederseni «Albanische Texte mit Glossar».

18), 19) — Trajta të së pakryerës me **-a** (veta e I) dhe **-te** (veta e III njëjës), krahas trajtave të tjera, kam dëgjuar në të folmen e personave të shkolluar dhe të dalë, po asnjëherë në të folmen e pleqve dhe të plakave analfabetë dhe të padalë.

hij. E bën dy mënyrësh të pakryerën edhe ndonjë folje e zgjedhimit të IV klasa e II: **shprierij** (nga rrënja **shpier**) dhe **shpij** (nga rrënja **shpi**).

Foljet e zgjedhimit të IV (këtu nuk përjashtohen foljet e klasës së II, që në vetat e tjera zgjedhohen sipas tipit të foljeve me temë në bashkëtingëllore) dhe ndonjë tjetër e bëjnë vetën e III njëjës zakonisht: **rii**, **vij** (ardhur), **bij**, **flij**, **lij**, **shpij**, **vij** (vënë), **zij**, **shij** (**shih** — B.), **njij** (**njih** — B.). Krahas kësaj trajte ndihet edhe një trajtë tjetër, e cila më është dukur më e rrallë: **rrin**, **shpin**, **vin**, **shin** etj.

Foljet ndihmëtare kanë në të pakryerën këto trajta: **kesh** (**keshij**), **keshe** (**keshje**), **kish**, **keshëm** (**keshm**), **keshët** (**kesht**), **keshën** (**keshn**), në Piqeras për këtë vetë ndihet edhe trajta **kin**: ato **kin** vatur, se **kin** dhit/, i **kin** vrar me **dufek**)/, **jesh** (**jeshij**), **jeshe** (**jeshje**), **ish**, **jeshëm** (**jeshm**), **jeshët** (**jesht**), **jeshën** (**jeshn**)/. Trajtat në kllapa i kam hasur më rrallë.

§ 51. E kryera e thjeshtë: a) Foljet, tema e të cilave mbaron me bashkëtingëllore marrin në njëjës mbaresat: **-a**, **-e** **-i** (**-u** për foljet që mbarojnë me bashkëtingëllore grykore) dhe në shumës (përveç atyre që mbarojnë me **I**, **II**, **rr** dhe kanë në rrënjë **ie** ose **je**, si edhe disa foljeve të zgjedhimit të II klasa e II) mbaresat: **-ëm**, **-ët**, **-ën**: **hapa**, **hape**, **hapi**, **hapëm**, **hapët**, **hapën**/, **naha**, **nähe**, **nähu**, **nähëm**, **nähët**, **nähën**/; **njgjita**, **njgjite**, **njgjiti**, **njgjitëm**, **njgjitët** **njgjitën**/, **brita**, **brite**, **briti**, **britëm**, **britët**, **britën**/.

Mbaresat e vjetra të së kryerës së thjeshtë shumës: **-m** (**ë**), **-t** (**ë**), **-n**(**ë**) ruhen rregullisht në foljet e zgjedhimit të I klasa e II, tema e të cilave mbaron me **I**, **II**, **rr** dhe kanë në rrënjë **ie** ose **je**, si edhe te «dal» e «marr». Me folje të tjera ato hasen në ato raste, ku qenia e tyre ka sjellë ndryshime fonetike, ato ruhen sot pikërisht në sajë të ndryshimeve fonetike të shkaktuara prej tyre.

tora, **tore**, **tori**, **tuarm**, **tuart**, **tuar** (< tuarnë)/, **dolla**, **dolle**, **dolli**, **duallm**, **duallt**, **duall** (< duallnë)/, **erdh** (< erdhnë), **hodh** (< hodhnë), **korr** (< kornë), me ta **ç pan** (< patnë²⁰), **plaçkin** (< plaçkitnë), **men** (< mbetnë), **dojn** (< dogjnë), **qemn** (< qepnë), **iñn** (< iknë), **pojt** (< poqtë), **godim** (< goditmë), **dijm** (< diqmë) etj.

Kjo kategori foljesh (klasa e I dhe e II) merr në tri vetat e shumësit edhe mbaresat **-tim**, **-tit**, **tin**: **çkultim**, **çkultit**, **çkultin**/, **hodhtim** (**hohtim**-B), **hodhtit**, **hodhtin**/, **muartim**, **muartit**, **muartin**/, **foltim**, **foltit**, **foltin**/.

b) Foljet me temë në zanore marrin mbaresat: **-v-a**, **-v-e**, **-i** (për foljet me **-oj** me **uaj**, dhe **-u** për gjithë foljet e tjera) **-m**(**ë**), **-t**(**ë**), **-n**(**ë**). Me këto mbaresa e bëjnë edhe disa folje të zgjedhimit të II klasa e II.

punova, **punove**, **punoi**, **punuam**, **punuat**, **punuan**/, **griva**, **grive**, **griu**, **grim**, **grit**, **grin**/, **lava**, **lave**, **lau**, **lam**, **lat**, **lan**/, **blova**, **blove**, **blói**, **bluam**, **bluat**, **bluan**/, **vova**, **vove**, **voi**, **viam**, **vuat**, **vuan**/, **preva**, **preve**, **preu**, **prēm**, **prēt**, **prēn**/ etj.

Folja «bëj» e bën të kryerën e thjeshtë **bëra**, **veta** e III njëjës **bëri** dhe **bë**; «rij» bën **riva**.

20) Në foljet e zgjedhimit të II klasa e I janë ruajtur më shumë mbaresat e vjetra dhe nga nevoja për të diferencuar trajtat e kësaj kohe nga trajtat e së tasmes dhe të së pakryerës: **këputën** (e **tashme**), **këputën** (e **pakryer**) — B., N.), **këpun** (e **kryer** e **thjeshtë**).

Disa folje me **-uaj**, **-aj** e ndonjë tjetër marrin në njëjës mbaresat: **-ta**, **-te**, **-ti**, të cilat i shtohen trajtës së vetës së I njëjës të së tashmes: **luajta**, **luajte**, **luajti//**, **shëtijta** (= tështita), **shëtijte**, **shëtijti//**, **arrijta**, **arrijte**, **arrijti//** **ndajta**, **ndajte**, **ndajti//**, **mbrujta**, **mbrujte**, **mbrujti//** etj.,

Në Piqeras dhe Nivicë disa folje si **liej**, **thiej** etj. që në shqipen e përbashkët kanë **ye**, e ruajnë **ie** në tri vetat e njëjësit të së kryerës së thjeshtë, veç theksi ndërron vend dhe i ndihet si gjysmë vokale: **lieva**, **lieve**, **lieu**, **liem**, **liet**, **lien//**, **thieva**, **thieve**, **thieu**, **thiem**, **thiet**, **thien//**.

Në Borsh **ie** (= **ye**), si në shqipen e përbashkët, shndërrohet në **e**: **leva**, **leve**, **leu** etj.

Jo vetëm foljet me **-uaj**, **-aj** dhe **-ij**, që e bëjnë njëjësin me mbaresat **-ta** etj., po edhe foljet e tjera, që marrin në njëjës mbaresat **-v-a** etj. (ndoshta edhe **-ta** etj.), kanë në tri vetat e shumësit edhe mbaresat **-tim**, **-tit**, **-tin**: **ndajtim**, **ndajtit**, **ndajtin//**, **mbrujtim**, **mbrujtit**, **mbrujtin//**, **arrijtim**, **arrijtit**, **arrijtin //**, **pagova**, **pagove**, **pagoi**, **paguam** dhe **paguajtim**, **paguat** dhe **paguajtit**, **paguan** dhe **paguajtin//** etj.

Mbaresat **-tim** etj. kanë një përhapje më të vogël në krahasim me mbaresat **-ëm** etj., — **m(ë)** etj.

Trajtat me mbaresat **-ta**, **-te** etj. për foljet e zgjedhimit të III janë sekundare. Këto mbaresa janë një përgjithësim analogjik i **t** së rrënjës së foljeve të zgjedhimit të II dhe mbaresave vetore të së kryerës së thjeshtë.

Mbaresat **-tim** etj. ndihen edhe në të folme të tjera të labërishtes e çamërishtes, ato hasen edhe në të folmen e arbëreshëve të Italisë²¹). Me se duket, këto mbaresa nuk janë dhe aq të reja. Ato duhet të jenë të njëkohëshme, në mos më të vjetra se mbaresat **-ëm** etj. Mbaresat **-tim** etj. duhet të kenë ardhur nga mbaresat **-tmë**, **-ttë**, **-tnë**²²) (M. Lambertze në fshatin arbëresh Portocanone shënon: **shkoitm**, **u ndajtm** dhe **ndajtim**), tek të cilat u zhvillua zanorja anaptitike **i**, ndoshta për analogji me vetën e III njëjës. Mbaresat **-tim**, **-tit**, **-tin** për foljet me temë, në bashkëtingëllore janë një shtrirje e mëtejshme analogjike.

Disa folje të zgjedhimit të IV e bëjnë kështu të kryerën e thjeshtë: ha: **hëngra** (hëŋra — B.), **hëngre**, **hëngri**, **hëngrëm**, **hëngrët**, **hëngrën**, (hëngër), shumë dhe **hëngërtim** etj.

rri: **ndënja** (nënja — B) **ndënje**, **ndënji**, **ndënjëm**, **ndënjët**, **ndënjën** (**ndëjn**), shumë dhe **ndëjtim** etj.

vete: **vajta**, **vate**, **vate**, **vani**, **vat**, **van//**.

bie: **prura** (pruva — P.), **prure**, **pruri** (pru), **prūm**, **prūt**, **prūn** (B.) //

shtie: **shtiva**, **shtive**, **shtiu**, **shtim**, **shtit**, **shtin** (P.) //

shpie: **shpura**, **shpure**, **shpuri** (shpu), **shpum**, **shput**, **shpun** (B.) //

vë: **vura**, **vure**, **vuri** (vu), **vum**, **vut** **vun** (B., P.) //

zë: **zura**, **zure**, **zuri** (zu), **zūm**, **zūt**, **zūn** (B., P.) //

Foljet: «kam», «gjej» dhe «vij» e bëjnë vetën e I njëjës me aorist sigmatik: **thash** sa **paç** **takan/** (<patsh), **arç** (B. <ardhsh), **gjeç** (<gjesh).

§ 52 — E ardhmja e tashme.- Kjo kohë shprehet me tri trajta:

Trajta më e rëndomtë është ajo që formohet nga e tashmja e lidhores e paraprirë nga pjesëza **do**; shpesh pjesëza të e lidhores nuk ndihet:

21) M. Lambertz, vep. e cituar.

22) Grupet **tm** e **tn** të këtyre mbaresave nuk janë asimiluar në **m** e **n** për të mos u identifikuar trajtat e së tashmes me të së kryerës së thjeshtë.

do të lidh, do të lidhç, do të japim, do t arrish, do të ziri; do rri, do bjer, do më viri në mur/ etj.

Haset këtu edhe trajta e së ardhmes e formuar nga e tashmja e foljeve ndihmtare «patur» dhe «qenë» dhe paskajorja e foljes: **e ke për të hedh/, kemi për të krasit, ka për të lar, ç'ish për të bër, të bëhet/.**

Në Piqeras e Nivicë e më ndonjë rast në Borsh është e gjallë edhe një trajtë e vjetër e së ardhmes e formuar nga e tashmja e dëftores e foljes «patur» dhe e tashmja e lidhores e foljes që mban kuptimin leksikor. Kjo e ardhme që haset edhe tek arbëreshët e Italisë dhe që këtu përdoret rrallë në krahasim me trajtat e tjera, ka zakonisht kuptimin e një të ardhmeje të domosdoshmërisë: **kam të dërgoj një pako në Vlor/, kam t i thom një gjë/, ka të vër dhe ai pjesën e tij./ kemi të japëm këtu, more Naqe/, ka të dërgoj çu proces-verbale/.**

E ardhmja e foljes «them» e ka humbur kuptimin primar dhe përdoret për të spjeguar diçka; në Borsh kam hasur vetëm këtë rast të së ardhmes së vjetër, që padyshim dikur duhet të ketë patur një përdorim më të madh: **ka të thot që kemi ndrishuar/, civila ka të thotë të paveshur/ (= civila do të thotë të paveshur).**

§ 53.- **Mënyra lidhore. Koha e tashme:** Veta e II njëjës si për foljet me temë në bashkëtingëllore, si për ato me temë në zanore merr mbaresën -ç: **të lidhç, të qepç, të dalç, të marrç, të japç, të sheç, të bëç, të kërrç, të sëllç, të shkruaç, të zëç** etj. Aty këtu ndeshen edhe raste, më shumë për foljet me temë në zanore, ku si mbaresë përdoret -sh: **të lidhësh, t ikish, t arrish, të biesh, të hash, të pish** etj.

Veta e III njëjës për foljet me temë në bashkëtingëllore ka mbaresën -ë, e cila si fundore ka rënë: **të lidh, të qep, të dal, të marr, të vjedh, të ngas, të shes.** Me mbaresën -ë, që i shtohet rrënjës së vjetër, e bëjnë këtë vetë edhe foljet e zgjedhimit të IV klasa e II: **të bjer, të lër, të vër, të zër** etj., në analogji me këto **të shor** (N. = të shohë). Më ndonjë rast të mbiti (N).

Foljet me temë në zanore marrin mbaresën -j(ë): **të blej, të punoj, të haj** etj. Po kështu të bëj.

Foljet: «kam», «jam», «dua», «thom», kanë këto trajta në vetën e III: **të ket, të jet, të det, të thet.**

§ 54.- **Mënyra kushtore.** Koha e pakryer e kësaj mënyre si në mbarë shqipëri formohet nga e pakryera e mënyrës dëftore e paraprirë nga pjesëza **do**. Po kam hasur edhe një rast të formuar nga e pakryera e foljes «patur» dhe nga e pakryera e lidhores e foljes që mban kuptimin leksikor: **e kesh ta bëj dhe një haur tjetër/ (P. = do ta bëja. . .).**

§ 55 - **Mënyra urdhërore.** Me që kjo mënyrë formohet përgjithësisht si në toskërishten e përbashkët, po ve në dukje vetëm ndonjë rast të veçantë. Në vetën e II njëjës foljet: «ngas», «pres», «vras», «bëj», bëjnë: **nga, pre, vra, bën.** Disa folje të zgjedhimit të III (foljet me -uaj) e bëjnë urdhëroren: **bluaj, shkruaj, ruaj.** Po kështu dhe **thuj.** Foljet e zgjedhimit të IV klasa e II dalin në urdhërore me rrënjën e vjetër: **bie — bjer** (po **bje-m, bje-na**), **shpie - shpjer, vë -vur, po lë -le, zë -ze.**

Në vetën e II shumës si edhe në vetën e II të së tashmes, folja merr mbaresën -ni (dhe variantin e saj -i) dhe zakonisht shndërrohen në i zanorja dhe je e rrënjës (në ato raste kur ndodh edhe në të tashmen): **ngini, prini, vrini, po edhe ngani, preni, vrani.** Foljet e zgjedhimit të IV klasa e II bëjnë: **biri, shpiri, viri, liri** (edhe lini), **ziri** (edhe zini). Në

pak raste hasen edhe variantet **-nij** e **-ij** të mbaresave **-ni** e **-i** të kësaj vete: **shinij, mirrij, ngrihij**.

§ 56.- **Pjesorja** --- Foljet në pjesore marrin këto mbaresa: a) **-ur**. Me këtë mbaresë e bëjnë pjesoren foljet, tema e të cilave në të kryerën e thjeshtë mbaron me bashkëtingëllore, veç atyre që mbarojnë me **-rr, -l, -ll** dhe apofonizojnë zanoren ose je të rrënjës: **ethur, ngulur, puthur, derdhur, hequr, dekur, gjetur, ardhur, vatur, patur** etj. Marrin këtë mbaresë dhe disa folje që në analogji me foljet e zgjedhimit të II klase e I e bëjnë aoristin me **-ta**: **njojtur (P.), pështijtur, mburjtur, ndajtur, rrojtur** etj.

Në analogji me këtë kategori foljesh marrin në pjesore mbaresën **-ur** dhe ato që mbarojnë me **-rr, -l, -ll** dhe e bëjnë aoristin me apofoni: **çjerrur, marrur, xjerrur, dalur, vjelur** etj.

Gjithashtu marrin **-ur** në pjesore të dytë edhe disa folje të zgjedhimit të IV klase e II e ndonjë tjetër: **thënur, lënur, vënur, zënur, qënur, dhënur**. Në analogji me këto e bën pjesoren dhe folja «kthej-»: **kthenur (P.)**

b) **-tur**. Kjo si mbaresë haset në pak raste si: **kalltur, thertur, vartur** dhe është formuar nga **t** e temës së foljeve të zgjedhimit të II klase e I dhe mbarosa **-ur**. Ky përgjithësim analogjik duhet të jetë bërë nëpërmjet foljeve të zgjedhimit të III, që e bëjnë aoristin me **-ta** si: **ndajta-ndajtur** etj.

c) **-ë** e cila si tingull fundor ka rënë. E marrin këtë mbaresë foljet që mbarojnë me **-rr, -l, -ll** dhe e bëjnë aoristin me apofoni: **marr, xjerr, dal, mbjell, pjell** etj. Po këto folje në një masë të tillë, në mos më shumë, marrin edhe mbaresën **-ur**, siç u përmend më lart.

Në të folmen e Bregdetit të Poshtëm si dhe në disa të folme të tjera të Labërisë, mbarosa **-ë** është shtrirë për analogji në foljet me temën e së kryerës së thjeshtë në bashkëtingëllore: **heq, nis, ñodh, këput, krasit, hedh mbledh, djeg, ik, luajt, arrit, ardh, vat** etj., gjithashtu **var**. Shembujt me mbaresën **-ur** dhe **-ë** qëndrojnë në një raport të tillë: **Nivicë-Bubar 17/4, Piqeras 21/17, Borsh 19/19**.

ç) **-n(ë)**. Me këtë mbaresë e bëjnë pjesoren një pjesë e foljeve të zgjedhimit të IV klase e II si dhe foljet «jam» e «them»: **dhën, ngrën, lën, vën, qën, thën**. Rastet me mbaresën **-n(ë)** në këtë të folme janë më të rralla s.a. ato që marrin dhe mbaresën e dytë **-ur**.

d) **-r (ë)**. Këtë mbaresë e marrin në pjesore foljet, tema e të cilave në të kryerën e thjeshtë del me zanore: **fshir, grir, rir, lier, çkatërruar, shpëtuar, rruar** (që i korespondojnë aoristit **rrova**).

Disa folje të tjera e bëjnë pjesoren: «bie» (prura) — **prur, «bie» (rash) — rar, shpie — shpur** dhe **shpurur, shtie-shtir**.

§ 57 — **Përcjellorja** — Për të formuar përcjelloren, pjesores së foljes i shtohet pjesëza **tuke**: **iesh tuke dalur**, shkon sokakut posht **tuke qar**, të vin **tuke bredhur** e **tuke qeshur, tuke rrukullisur**, **tuke ardhur** noshërat, **do lartoneç**, etj.

Format gramatikore të foljeve të diatezës pësore etj.

§ 58.- **Koha e tashme**.- Foljet e diatezës pësore, mësores dhe vetvetore marrin në këtë kohë mbaresat: **-em, -ej, -et, -emi, -ij, -en**. Foljet me temë në zanore midis temës dhe mbaresës marrin, veç jo gjithnjë, bashkëtingëlloren antihiatizuese **h**; foljet me **-oj, -ej** dhe «bëj» në të shumtën e herëve kanë para mbaresës bashkëtingëlloren **n**: **lahem** (dhe **lae** n),

lahej, lahet, lahemi, lahi, lahen//, kthenem (dhe kthehem) kthenej, kthehet, kthenemi, kthenij, kthenen//, bënem (dhe bëhem), bënej, bënet, bënemi, bënij, bënen//.

E tashmja e foljeve «them» e «los» gjithashtu formohet me anë të këtyre mbaresave, po këto i ngjiten një teme që sot është e njëjtë me atë të vetës së III njëjës të së tashmes, ndërsa në toskërishten e për-bashkët rrënja e së tashmes pësore e foljes «them» është e njëjtë me atë të vetës së II njëjës (thu-a) dhe e «los» është e njëjtë me atë të vetës së II shumës (lo-ni): ipi **thotet** kur... (= thuhet)/, ato **thoten** çulla (= thuhet)/, s të **lotet** ajo atje (= lohet)/.

Veta e II njëjës e kohës së tashme të lidhore ka mbaresën **-eç**: të **lidheç**, të **laheç**, të **kujtoneç** etj.

§ 59 — E pakryera. Mbaresat e njëjësit të kësaj kohe janë: **-esh, -eshe, -ej**. Si edhe në të tashmen për foljet me temë në zanore çfaqet h ose n: **futesh, futeshe, futej/, lahesh, laheshe, lahej/, martonesh, martoneshe, martonej/.**

Në Borsh për shumësin ndihen mbaresat: **-ishm, -isht, -ishn: futishm, futisht, futishm/, lahishm, lahisht, lahishm/.**

§ 60.- E kryera e thjeshtë. Veta e parë bëhet me aorist sigmatik, rrallë me aorist asigmatik. Si foljet me temë në bashkëtingëllore si ato me temë në zanore marrin mbaresën **-ç**, në një rast **-sh**: **u ngopç, u plakç, u trëmbç, u doç, u mblodhç, u poç, u ftoç, u gabuaç, u kujtuaç, u përvëluaç, u kthesh**, rrallë edhe **u ftoha, u dogja**.

Folja «bëj» në vetën e II të kësaj kohe paraqitet me mbaresë: **u bëri** sa kjo di vjeçe/ (B).

Ndajfolja

§. 61 — Nga ndajfoljet po përmend:

a) Ndajfolje vendi: **tuk** (= tek): kjo ndajfolje, për sa kam regjistruar, përdoret në fjalitë që janë përgjigjja e një fjalie pyetëse: (Ku e kemi?) — ja mo **tuk** e kemi/, (Ku pikon?) — na ja mo **tuk** pikon/, (Ku e kemi sufran?) — na ja **tuk** e kemi sufran/.

b) Ndajfolje kohe: **pra** (= pa, pastaj); përdoret në fjali të bashkërenditura, që tregojnë suksesion kohor: dale të vij ai, **pra** te thom/, bjem mua nja di koqe ullinj, **pra** meru me pun/, qeni nuk vuri një çik thikën në brinj të tij, **pra** ti vrit/, do më dërgoj rroba të sirta, **pra** të vete/, **nashti** (= tashti), **parthin** (N. = qëpari), luftuam tër **dita** me taj (= tërë ditën).

c) ndajfolje sasi: **meaft** (N. = mjaft): ka bër **meaft/**.

Parafjala

§. 62 — Në këtë të folme përdoret parafjala te (para emrave në rasën emërore, që fillojnë me bashkëtingëllore) dhe tek (para emrave që fillojnë me zanore); në Borsh kam ndeshur edhe **tuk**: varet **te** drut/ t e vër **te** Metua/, vate **te** mbreti/: të viç këtu **tek** u/, e vura **tek** ulliri/ as **tek** ajo s kam vat/, **tuk** e katërta e vë prap/, s e kam fjalën **tuk** ki/, ja **tuk** ki fiku/.

Për të treguar lëndën me të cilën është mburrur ose endur një send, nërdoret parafjala nga e jo prej: bërruca **nga** lesh bënet/, sikur të jet

nga lesh, i thomi zhile/etj. Parafjala përtej dhe përjashta e duan emrin në rasën kallzore: përtej fshatin, përtej Gjirokastrën, përjashta derën në h'e/.

Lidhëza

§ 63 — Po përmend disa që janë karakteristike:

a) Si lidhëza bashkërenditëse veçonjëse përdoren edhe: **ndo.....ndo, i...i** (<gr.) **i** (<gr.); u do ta bëj, e ju **ndo** hajdeni. **ndo** mos hajdeni/, dhe i kthejëm xhevapin i e, i jo/, i u, i ti/, duam kaq napolona, i djelt do t ua vrasëm/.

b) Lidhëza nënrenditëse mënyrore: **sikundër, sikundër që** (N.) dua të t e thom **sikundër** isht/, ki do një **sikundër q** isht vet/.

c) Lidhëza nënrenditëse kushtore. Nga këto po përmend: **po qe që, kurse** (P.N.), **posa** (B), **në mos që, në qoft se** (B.P): **po qe** që do maen, i mam/, **kurse** një grur e ka vrar reja, thomi: «i ra...»/ (= Nëqoftëse një grurë...), **posa** s je bër ti mënjemath, mua më plaçin këta/ (=Nëqoftëse s'je bërë ti mëndjemadh, mua...), **në mos që** na peqoft nonjë shi, do të vete vet/ (=Nëqoftëse nuk na pengon ndonjë shi, do të vete vetë.), **në qoft se** ai ka gjetur tia, ti e fillon/.

R é s u m é

LE PARLER DU BREGDETI POSHTËM

La région du Bregdeti Poshtëm (la partie inférieure du littoral S.-W. de l'Albanie) s'étend sur le littoral de la mer joniennne. Avec cette étude l'auteur a voulu donner, brièvement, les traits généraux du parler de cette région et fixer sa place parmi les autres parlers du dialecte tosqe.

A l'exception du parler de Borsh, celui des autres villages forme une unité linguistique. Celle-ci est caractérisée par l'existence des voyelles longues, l'absence du phonème y, l'assourdissement des consonnes sonores à la fin du mot ou au milieu devant des consonnes sourdes. En morphologie, ce parler est caractérisé par l'emploi de l'article antérieur e après des noms féminins déterminés (tantôt même après des noms masculins déterminés) au génitif-datif: e vë në sis të mëmës e tia/, vajze djalit e madh/. Une autre particularité de ce parler est l'emploi de la forme ablative déterminée au lieu de celle indéterminée: uj pusit (=ujë pusi), kuti kafes (=kuti kafeje), etc.

Borsh, étant plus près de Kurvelesh et musulman, a eu, comme à dire, une position à part entre les autres villages chrétiens. Il a

entretenu des rapports étroits avec les villages de Kurvelesh inférieur, par conséquent, même dans son parler on observe des innovations propres à Kurvelesh, du genre de celles-ci: assimilation des groupes consonnantiques *mb, nd, ng, ngj* respectivement en *m, ñ, ŋ, nj*. A différence du parler des autres villages, dans le parler de Borsh on assourdit les consonnes sonores à la fin du mot ou au milieu devant des consonnes sourdes, et de même on n'entend pas le son fricatif mi-labial sourd *h*.

Sur un plan plus général, le parler de cette région constitue une unité avec les parlers du Bregdeti sipërm (la partie supérieure du littoral), Kurvelesh et Rrëzomë, de là il peut être considéré comme un parler du sous-dialecte de la labërishte.